

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6865
E hënë, 3 prill 2023
çmimi 0.40

Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi nisin sot betejën për mbrojtjen e UÇK-së

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MIJËRA QYTETARË IU BASHKUAN THIRRJES SË PLATFORMËS
"LIRIA KA EMËR" PËR "MARSHIN PËR DREJTËSI" ■ FAQE 4-5

'MARSHI PËR DREJTËSI' BASHKON QYTETARËT PËR NDËRMARRJEN E PËRBASHKËT ÇLIRIMTARE




Sheshet e Prishtinës asnjëherë nuk janë dukur më të bukura dhe me më shumë qytetarë sesa të dielën. Mijëra qytetarë nga e gjithë Kosova dhe trojet shqiptare i janë bashkuar

"Marshit për drejtësi" në mbështetje të liderëve të UÇK-së ndaj të cilëve sot (e hënë) fillon procesi gjyqësor në Hagë. Nga të gjithë të pranishmit kryefjalë e këtij marshi kanë qenë:

UÇK-ja, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Po ashtu, ata kanë kërkuar nga Gjykata Speciale drejtësi për çlirimtarët

OPINION



MUHAMET MAVRAJ: MESAZHI I 2 PRILLIT DUHET TË KUPTOHET MIRË DHE DREJT, BRENDA DHE JASHTË, SERIOZISHT ■ F.7

AKTUALE



PAPA KRYESON MESHËN NJË DITË PAS LIRIMIT NGA SPITALI ■ F.3

SULMOHEN DISA POLICË NË MITROVICË TË VERIUT ■ F.3

HOVENIERI PËR DJEGJEN E VETURAVE NË VERI: QEVERIA TË KËRKOJË LLOGARI PËR KËTO VEPRA KRIMINALE ■ F.5

EKONOMI



INFLACIONI I EUROZONËS BIE NDJESHËM NË MUAJIN MARS ■ F.8

TAHIRI I AAK-së: SISTEMI I PAGAVE NË KATRAHURË ■ F.8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Papa kryeson meshën një ditë pas lirimit nga spitali

ROME, 2 PRILL - Papa Françesku kryesoi meshën e të Dielës së Palmave në sheshin e Shën Pjetrit të dielën, duke nisur kështu ngjarjet e shumta deri në festën e Pashkëve, vetëm një ditë pasi u lirua nga spitali.

86-vjeçari ishte shtrirë në spital të mërkurën, më 29 mars, shkaku i vështirësive në frymëmarrje.

Hospitalizimi i tij kishte nxitur shqetësime se ai mund të mos rikuperohet në kohë për t'i ndjekur ngjarjet e javës më të ngarkuar në agjendën vjetore të tij. Por, Papa Françesku kishte premtuar se do të ishte i pranishëm në meshën e së dielës dhe ai i përshëndeti për pak momente rreth 3 000 njerëz tek

kaloi me veturën e tij nëpër sheshin e stolitur me mbi 35 000 lule.

Ai dukej serioz derisa ndiqte procesionin nëpër sheshin e Shën Pjetrit, ku ishin grumbulluar edhe kardinalët me rroba të kuqe, të stolitur me gjethe të mëdha palme dhe degë ulliri.

E Diela e Palmave shënon mbërritjen e Jezusit në Jerusalem para kryqëzimit të tij. E diela e Pashkëve, e cila këtë vit është më 9 prill, feston ringjalljen e tij.

Përderisa Papa ishte larguar i buzëqeshur nga spitali Gemelli në Romë të shtunën pas një qëndrimi prej tre netësh, ai u tall me turmën e njerëzve të cilët e

pyesnin se si ishte duke thënë "Jam ende gjallë!".

Kreu i 1.3 miliard katolikëve në botë është përballur me disa probleme shëndetësore gjatë viteve të fundit, përfshirë këtu problemet e gjurit që e kanë detyruar atë të përdorë një karrige me rrota dhe shkop për ecje.

Këto probleme shëndetësore kanë ngjallur shqetësime se ai mund të zgjedhë të pensionohet. Françesku shënoi 10-vjetorin si kreu i Kishës Katolike mbarëbotërore në fillim të këtij muaji. Ai ka nxitur reforma të mëdha në qeverisje dhe ka kërkuar të krijojë një Kishë më të hapur, megjithëse është përballur



me kundërshtimin e brendshëm, veçanërisht nga konservatorët. Ai ka thënë në mënyrë të përsëritur se do të konsideronte dorëheqjen

nëse përkeqësohet gjendja e tij shëndetësore. Por, muajin e kaluar ai tha se, për momentin, nuk planifikon të japë dorëheqje.

Zelensky e quan "absurde" presidencën ruse të Këshillit të Sigurimit



KIEV, 2 PRILL - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, e ka kritikuar marrjen e presidencës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së nga Rusia "absurde dhe shkatërruese". Sipas tij, kjo e dëshmon "falimentimin e plotë të institucioneve ndërkombëtare".

Duke folur në orët e vona të së shtunës, 1 prill, Zelensky tha se "ata që janë përgjegjës për terror" nuk duhet të lejohen të kryesojnë organet ndërkombëtare. "Ushtria ruse vrau një tjetër fëmijë ukrainas - një djalë 5 muajsh nga Avdijivka... Dhe në të njëjtin moment, Rusia kryeson Këshillin e Sigurimit të OKB-së", tha Zelensky.

Ndërkohë, shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell, tha se Bashkimi Evropian do ta

kundërshtojë çfarëdo tentimi për abuzim të presidencës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së nga Rusia gjatë muajit prill. "Pavarësisht se Rusia është një anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit, Rusia vazhdimisht e shkel thelbin e kuadrit ligjor të OKB-së", tha Borrell në "Twitter".

Më herët, ministri i Jashtëm i Ukrainës, Dmytro Kuleba, e quajti marrjen e presidencës nga Rusia "një shuplakë në fytyrë për komunitetin ndërkombëtar". Ai u kërkoj anëtarëve të tjerë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së që të mos e lejojnë Moskën të abuzojë me presidencën e saj.

Këshilltari presidencial në Ukrainë, Mykhaylo Podolyak, tha se kjo ngjarje ishte "një tjetër përdhunim i ligjit ndërkombëtar".

"Një ent që bën një luftë agresive, shkel normat e ligjit humanitar dhe penal, shkatërron Kartën e OKB-së, neglizhon sigurinë bërthamore, nuk mund ta kryesojë organin kryesor të sigurisë në botë", tha Podolyak në "Twitter".

Rusia mori presidencën njëmuajore, e cila ndërrohet në bazë të një rendi, të Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 1 prill - për herë të parë që nga shkurti i vitit 2022, kur nisi luftën e saj të paprovokuar kundër Ukrainës.

Pushtimi rus i Ukrainës shkeli Kartën e OKB-së, e cila kërkon që shtetet të përmbahen nga përdorimi i forcës kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të një shteti tjetër.

Tornado në ShBA, rritet numri i viktimave

Uashington, 2 prill - Të paktën 26 persona kanë mbetur të vdekur shkaku i një serie tornadosh që goditi qytete të shumta në pjesët jugore dhe perëndimore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Shumë shtëpi mbetën të shkatërruara dhe mijëra njerëz mbetën pa energji elektrike, pasi që tornadot shkaktuan dëme të shumta në disa shtete.

Sipas gazetës amerikane "Washington Post", më shumë se 60 tornado janë regjistruar në këto vende.

Në shumë shtete - si Arkansas, Tenësi, Illinoi, Indiana, Alabama dhe Misisipi - është raportuar edhe për viktima në njerëz.

Njëra nga tornadot e shumtë e goditi edhe qytetin Wynne të Arkansasit, rreth 170 kilometra larg kryeqytetit Little Rock.

Një banore e këtij qyteti, Ashley Macmillan, tha se ajo, burri i saj dhe fëmijët e tyre u grumbulluan me qentë e tyre në një banjë të vogël gjatë stuhisë, "duke u lutur dhe duke i thënë lamtumirë njëri-tjetrit, sepse menduam se do të vdisnim".

Shtëpia e tyre u dëmtua shumë nga një pemë e madhe që ra mbi shtëpi, por ata nuk u lënduan. "Ne mund ta ndjenim shtëpinë duke u dridhur, dëgjonim zhurma të forta, pjatat tekta thyeshin. Dhe pastaj u qetësua", tha Macmillan për agjencinë e lajmeve AP.

Gubernatorja e Arkansasit, Sarah Huckabee Sanders, shpalli një gjendje të jashtëzakonshme të premtën, duke aktivizuar gardën kombëtare për të ndihmuar në përpjekjet për rikuperim. Ajo

tha se kishte folur me presidentin Joe Biden për situatën dhe se ai i kishte premtuar ndihmë federale.

Përderisa stuhia vazhdon të shkojë drejt lindjes, qindra mijëra njerëz janë pa energji elektrike në disa shtete.

Virxhinia, Ohio dhe Pensilvania janë më të prekurat, sipas faqes së internetit të ShBA-së, PowerOutage.

Stuhia e së premtës shkaktoi gjithashtu shembjen e një çatie teatri në një koncert të mbushur në Belvidere të Illinoi, duke lënë kështu një person të vdekur dhe 28 të plagosur.

Tornadot vdekjeprurëse vijnë një javë pasi një tjetër tornado vrau 26 njerëz në Misisipi.

Presidenti Biden vizitoi shtetin të premtën për të shprehur ngushëllimet e tij.



Sulmohen disa policë në Mitrovicë të Veriut

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

MITROVICË, 2 PRILL - Në orët e hershme të së dielës një mjet shpërthyes është hedhur në drejtëm të zyrtarëve policorë në Mitrovicë të Veriut, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Policia ka njoftuar se sulmi është kryer rreth orës 2:20 të natës “nga persona deri tani të panjohur”, ndërsa shton se mjeti shpërthyes i hedhur në rrugën “Ivo Lloja Ribar”, te Qendra e Kontrollimit Teknik të Automjeteve, dyshohet të jetë shok bombë.

Sipas njoftimit, prokurori i shtetit ka urdhëruar nisjen e hetimeve për këtë rast si “sulm ndaj personit zyrtar”.

Në komunikatën e policisë nuk bëhet me dije për gjendjen dhe numrin e policëve të sulmuar.

Ky incident vjen pas disa rasteve të raportuara për djegie të veturave me targa RKS në veri të Kosovës, zonë e banuar me shumicë serbe. Mbrëmjen e së shtunës, më 1 prill, Policia e Kosovës lajmëroi se e kishte arrestuar një person për pjesëmarrje në një sulm ndaj një njësie të Policisë së Kosovës, “pjesëmarrje apo organizim të grupit të organizuar kriminal”, “vrasje në tentativë”, “shkaktim i

rrezikut të përgjithshëm” dhe “sulm ndaj zyrtarit gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”.

Pas këtij arrestimi, Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve të Kosovës, e mbështetur nga Beogradi zyrtar, e cilësoi arrestimin në Mitrovicë të Veriut si “vazhdim të keqtrajtimit të popullit serb” dhe paralajmëroi se nëse i arrestuari nuk lirohet, do të shkaktohet “reagimi nga serbët”.

“Për ta sqaruar, ky nuk do të jetë ndonjë paralajmërim, por një kryengritje e përgjithshme për ta ndaluar shtypjen e Albin Kurtit ndaj qytetarëve të pafajshëm”, thuhet në deklaratën e Listës Serbe.

Edhe Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë ka reaguar duke e akuzuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, se “po shkakton kaos dhe po krijon një krizë të re”.

Djegia e veturave ka filluar vitin e kaluar, kur nisi procesi i reregjistrimit të veturave me targa KM në targa RKS. Targat KM lëshohen nga autoritetet e Serbisë dhe Kosova i konsideron ilegale. Ky proces shkaktoi tensione në terren. Fillimisht më 31 korrik u ngritën barrikada për këtë çështje, më pas në nëntor serbët u larguan nga institucionet e Kosovës në veri shkaku i suspendimit të drejtorit të



Policisë për rajonin e veriut, Nenad Gjuriq, i cili refuzoi ta zbatojë vendimin e Qeverisë së Kosovës për reregjistrim në targa RKS. Ndërkohë, Kosova dhe Serbia, me insistimin e bashkësisë

ndërkombëtare, në fund të nëntorit të vitit të kaluar arritën një marrëveshje për targat në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Kosova pranoi ta pezullojë procesin e reregjistrimit,

ndërsa Serbia u pajtua të mos lëshojë targa të reja për makinat që qarkullojnë në Kosovë. Vlerësohet se në veri të Kosovës janë rreth 10 000 vetura të regjistruara me targa KM.

Hovenieri për djegien e veturave në veri: Qeveria të kërkojë llogari për këto vepra kriminale



PRISHTINË, 2 PRILL - Ambasadori i ShBA-së në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka reaguar në lidhje me djegiet e veturave në veri të Mitrovicës. Hovenieri ka thënë se Qeveria e Kosovës ka përgjegjësi t'i mbrojë qytetarët e saj dhe të sigurojë llogaridhënie për këto vepra kriminale. “ShBA-ja vazhdimisht e ka dënuar djegien kriminale të veturave në veri të Kosovës. Qeveria e Kosovës ka përgjegjësi t'i mbrojë qytetarët e saj dhe të sigurojë llogaridhënie

për këto vepra kriminale”, ka shkruar Hovenier në “Twitter”. Edhe ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rode, shkroi se pse Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë - nuk i dënoi incidentet në komunat në veri. “Është shumë shqetësuese që Lista Serbe nuk e dënoi përsëri djegien e veturave të qytetarëve. Të gjithë duhet të jenë të bashkuar në dënimin e kësaj praktike”, ka shkruar ai në “Twitter”.

Daçiqi akuzon autoritetet e Kosovës se po krijojnë krizë të re

PRISHTINË, 2 PRILL - Ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Daçiq, tha të dielën se përmes arrestimit të serbëve në Kosovë, Qeveria e Kosovës dëshiron ta destabilizojë gjendjen dhe t'i shmangë detyrimet që ka ndërmarrë përmes marrëveshjes së Ohrit.

“Është shumë e qartë se një situatë e vjetër është në horizont dhe një krizë e re e prodhuar nga Prishtina”, tha Daçiq.

Ai i bëri thirrje komunitetit ndërkombëtar që të “reagojë urgjentisht” dhe të bëjë presion

mbi autoritetet në Prishtinë për ta parandaluar përshkallëzimin e situatës.

Daçiqi e dha këtë deklaratë pas takimit të Byrosë për Koordinim të Shërbimeve të Sigurisë të Serbisë, një ditë pasi Policia e Kosovës arrestoi një pjesëtar të komunitetit serb në Mitrovicën e Veriut në kuadër të një aksioni për luftimin e krimit të organizuar dhe parandalimin e kryerjes së veprave kriminale.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ranë dakord

në Ohër të Maqedonisë së Veriut më 18 mars se do ta vazhdojnë zbatimin e propozimit të BE-së për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve. Zyrtarët evropianë kanë thënë se marrëveshja e Ohrit, edhe pse e panënshkruar, është ligjrisht e detyrueshme për të dyja palët. Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, tha të dielën se më 2 prill Kurti “dëshiron kriza dhe nëpërkëmbje të marrëveshjeve”, sepse nuk dëshiron ta formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.





MIJËRA QYTETARË IU BASHKUAN THIRRJES SË PLATFORMËS
“LIRIA KA EMËR” PËR “MARSHIN PËR DREJTËSI”

‘Marshi për drejtësi’ bashkon qytetarët për ndërmarrjen e përbashkët çlirimtare

Sheshet e Prishtinës asnjëherë nuk janë dukur më të bukura dhe me më shumë qytetarë sesa të dielën. Mijëra qytetarë nga e gjithë Kosova dhe trojet shqiptare i janë bashkuar “Marshit për drejtësi” në mbështetje të liderëve të UÇK-së ndaj të cilëve sot (e hënë) fillon procesi gjyqësor në Hagë. Nga të gjithë të pranishmit kryefjalë e këtij marshi kanë qenë: UÇK-ja, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Po ashtu, ata kanë kërkuar nga Gjykata Speciale drejtësi për çlirimtarët

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 2 PRILL - Qytetarët e Kosovës të dielën i janë përgjigjur pozitivisht platformës “Liria ka emër” për të marshuar për drejtësi, në mbështetje të liderëve të UÇK-së, ndaj të cilëve sot (e hënë) fillon procesi gjyqësor në Gjykatën Speciale në Hagë. “Marshit për drejtësi” i janë

bashkuar përfaqësues të partive politike dhe familjarët e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Përpos flamurit të Kosovës, atij kombëtar dhe të UÇK-së, qytetarët mbanin në duar edhe pllakatet me mbishkrimet: “Liria ka emër”, “UÇK-ja, krenaria jonë”, “Drejtësi për çlirimtarët” etj.

Ideatorët e platformës “Liria ka

emër”, Ismail Tasholli dhe Eliza Hoxha, kanë falënderuar të gjithë qytetarët që në mënyrë masive i janë përgjigjur thirrjes për të marshuar për drejtësi për krerët e UÇK-së që po mbahen padrejtësisht në Hagë, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe bashkëluftëtarët e tyre. Tasholli ka thënë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës është vlera më sublime që ka krijuar kombi





ynë. “Ju falënderoj nga zemra që i jeni bashkuar thirrjes sonë për drejtësi. UÇK-ja është emëruesi ynë i përbashkët. Është vlera më sublimë që kemi krijuar si komb. Ne, si komb, njëzëri, bashkë, marshojmë kundër ndryshimit të historisë. Marshojmë për drejtësi. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi fillojnë nesër betejën e radhës. Betejën për të vërtetën dhe drejtësinë. Si gjithmonë, do të na kthehen fitimtarë e faqebardhë”, ka thënë Tasholli. Ndërsa Eliza Hoxha është shprehur se UÇK-ja dhe thirrja për drejtësi i ka bashkuar të gjithë qytetarët e Kosovës. “Gjatë këtyre dy javëve, anekënd Kosovës, bashkë me Ismajlin e kam rijtuar historinë tonë. E kam ndier dhimbjen e nënës Ferdonije, guximin e Shyhretes dhe Vasfijes, stoicizmin e Fahrije Hotit, qëndresën e bacës Shaban. E kam parë dhe ndier sa e gjallë dhe sa e hapur

vazhdon të jetë plaga jonë dhe thirrja për drejtësi. Përlësisht, ju falënderoj nga zemra që jeni me ne sot. UÇK-ja na bashkon. Të gjithëve. Pa dallim. Thirrja për drejtësi na bashkon. E unë jam e bindur se ky shesh do të trumbetojë sërish në ditën e kthimit të luftëtarëve tanë”, ka thënë ajo.

Më tutje, Hoxha ka rikujtuar prillin e 24 vjetëve më parë kur qytetarët e Prishtinës ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre, për t’u kthyer pas disa muajsh në Kosovën e lirë, pas fitores së luftës së UÇK-së. “Si sot, 24 vjet më parë, Prishtina ishte shndërruar në një qytet fantazmë. Lumi i njerëzve të dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre nga ushtria dhe paramilitarët serbë kishte mërsyer stacionin e trenit. Ai stacion, që ishte i mbyllur për më shumë se dhjetë vjet, u hap atë ditë për të na dëbuar jashtë Kosovës, në një rrugë pa kthim. Po ne u kthjem, e këto sheshe u mbushën prapë, për ta festuar

çlirimin dhe pavarësinë. Si fotografe e re atëbotë, i mbaj mend shkrepjet e fytyrave me lot gëzimi kur të gjithë bashkë shënonim ato fitore të mëdha. E këto fitore epokale, do të ishin të pamundur pa guximin, luftën dhe vetëmohimin e pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, ka thënë ajo.

“UÇK-ja nuk ka kryer krime dhe nuk është në asnjë formë organizatë kriminale, por një organizatë çlirimtare”

Flaka Fazlia, vajza e dëshmorit Fatmir Fazlia, ka thënë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës është organizatë çlirimtare dhe bota nuk duhet t’ia lejojë vetes që në emër të drejtësisë të dënojë njerëz të pafajshëm. “UÇK-ja nuk ka kryer krime dhe nuk është në asnjë formë organizatë kriminale, por një

organizatë çlirimtare. Pjesëtarët e UÇK-së ishin njerëz të cilët dënesën e dhimbjeve tona kolektive e kthyen në zë të fuqishëm, të cilin e dëgjoi e gjithë bota, në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO dhe BE. Bota nuk duhet t’ia lejojë vetes që në emër të drejtësisë të dënojë njerëz të pafajshëm”, është shprehur ajo.

Kurse ish-ushtari i UÇK-së, Kjani Guri, ka thënë se liria e Kosovës ka emrin e sakrificës, martirëve, heronjve tanë dhe të UÇK-së. “Jemi sot bashkë këtu për të kërkuar drejtësi. Për ta mbrojtur me këmbëngulje historinë tonë të lavdishme. Në UÇK kanë qenë bijat dhe bijtë tanë më të mirë, të cilët luftuan për lirinë e atdheut. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe të tjerët nuk janë emra të përveçëm, por janë historia jonë të cilën nuk do ta lejojmë të rishkruhet”, ka thënë Guri.

Një fjalë rasti e ka mbajtur edhe

kryetari i Shoqatës “Zëri i Prindërve”, Bajram Qerkini, i cili ka thënë se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi janë liria jonë dhe do ta kalojnë edhe këtë sfidë. “Rrofshin të rënë tanë! Rroftë ky popull! Ne po duam drejtësi për lirinë. Kemi luftuar për liri dhe nuk po e gëzojmë”, ka thënë Qerkini.


Ndërsa simboli i grave të Krushës dhe të gjithë grave të forta shqiptare, Fahrije Hoti, është shprehur e indinjuar që sot para gjykatës po dalin çlirimtarët e vendit e jo ata që kryen krime në Kosovë. “Jam sot bashkë me ju që të kërkojmë drejtësi për luftëtarët e lirisë. Jam sot me ju për të kërkuar drejtësi për të ardhmen. Familja ime dhe Krusha ende kërkojnë drejtësi edhe 24 vjet pas luftës. Edhe bashkëshorti im është ende i pagjetur. Në vend të kriminelëve, sot, fatkeqësisht, para gjykatës po dalin çlirimtarët e vendit tonë”, ka thënë Fahrije Hoti.





Krasniqi: Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi do të rikthehen fitimtarë siç erdhën dikur si çlirimtarë

Qytetarëve në këtë manifestim madhështor u është drejtuar edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, i cili ka thënë se nuk ka dyshim që Thaçi, Veseli, Krasniqi, Selimi e bashkëluftëtarët e tyre do të rikthehen fitimtarë ashtu siç erdhën dikur si çlirimtarë. "Sot, ballëllartë e me zemër plot, marshojmë krenarë, për ata që dikur marshuan drejt lirisë. Marshojmë për të kërkuar drejtësi, për ata që nga nesër do të përballen me një proces gjyqësor, në të cilin nuk janë për shkak të emrave të tyre të përveçëm, por për shkak të epokës së lavdishme që përfaqësojnë. Marshojmë për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin, Rexhep Selimin dhe bashkëluftëtarët e tyre që sot janë larg nesh, duke e zhvilluar betejën e fundit, për dinjitetin dhe të vërtetën e luftës sonë për liri. Dhe duke besuar fuqishëm në drejtësi, nuk kemi dyshim se do të



rikthehen fitimtarë, ashtu siç erdhën dikur si çlirimtarë, sepse janë heronj të gjallë që, përveç lirisë, s'kanë pasur një mision të dytë dhe, përveç pavarësisë, s'kanë pasur një projekt rezervë. Sot ne solidarizohemi me ta, sepse ata janë pasqyra e një rrugëtimi historik e kombëtar, demokratik e qytetëruar, por që s'ka përfunduar ende", ka thënë Krasniqi.

Ai ka ftuar qytetarët ta ruajnë frymën e unitetit, për ta ripërtërirë përkushtimin për Kosovën, të cilën çlirimtarët e kanë ëndërruar. "Ky është obligimi që kemi edhe ndaj Hashimit, Kadriut, bacës Jakup, Rexhës, Calit, Hysit, Nasimit e Pjetrit. Dhe kjo duhet të jetë rruga jonë e përbashkët për Kosovën e ëndrrave tona. Për Kosovën që na bashkon e në të cilën dielli do të lindë përsëri. Lavdi e përjetshme për të gjithë të rënë për lirinë e Kosovës. Drejtësi për çlirimtarët tanë", ka thënë Krasniqi.

Krasniqi ka kërkuar drejtësi për të vërtetën dhe historinë e popullit tonë, të cilat, sipas tij, askush, kurrë dhe me asgjë nuk do të mund t'i ndryshojë e t'i shtrembërojë. "Lufta e popullit tonë për çlirim nuk ishte thjesht një ballafaqim ushtrish, por një

luftë ndërmjet lirisë dhe tiranisë, ndërmjet drejtësisë dhe të padrejtës, ndërmjet shpresës dhe dëshpërimit. Dhe ne ishim të rreshtuar në anën e lirisë, drejtësisë dhe shpresës. Prandaj, po! Ne kërkojmë drejtësi, sepse për krimet e panumërta ndaj qytetarëve tanë, mijëra kriminelë serbë nuk kanë dalë kurrë para drejtësisë. Por, mbi të gjitha, kërkojmë drejtësi, sepse drejtësia është virtyti që e vulos të vërtetën dhe historinë e popullit tonë, të cilat askush, kurrë dhe me asgjë, nuk do të mund t'i ndryshojë e t'i shtrembërojë", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se lavdia e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk mund të pakësohet me kalimin e viteve, as nuk tjetërsohet me ndryshimin e gjeneratave. "Kjo pamje është mesazhi më i qartë dhe më i drejtpërdrejtë, se liria jonë ka emër dhe se lavdia e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk pakësohet me kalimin e viteve, as nuk tjetërsohet me ndryshimin e gjeneratave. Dhe se çdo gjeneratë e së ardhmes do ta ketë po të njëjtin emocion si gjeneratat e të sotmes sa herë që i thërret tri shkronjat e arta të lirisë sonë: UÇK!", ka përfunduar Krasniqi. →



Muhamet Mavraj: Mesazhi i 2 prillit duhet të kuptohet mirë dhe drejt, brenda dhe jashtë, seriozisht



PRISHTINË, 2 PRILL - Mijëra qytetarë të dielën marshuan për drejtësi në Prishtinë në përkrahje të ish-krerëve të UÇK-së.

Duke komentuar "Marshin për drejtësi", ku edhe vet botuesi Muhamet Mavraj mori pjesë në këtë marsh, ka thënë se mesazhi i 2 prillit duhet të kuptohet mirë dhe drejt, brenda dhe jashtë, seriozisht.

Ai ka shkruar në "Facebook" se prej 3 prillit nuk fillon gjyqi kundër luftës sonë, por i gjykatës kundër vetvetes dhe kësaj farës jugosllave

që përfitoi përkohësisht me ndihmën e kësaj gjykate. "Do t'i mbrojmë vlerat tona të lirisë dhe pengjet e Hagës do të kthehen triumfatore", ka shkruar Mavraj. Ai ka shprehur falënderim për qytetarët që treguan civilizim në këtë marsh dhe për organizatorët.

Postimi i Mavrajt:

Gjallë jemi! Këtu dhe kështu do të mbesim.

Mesazhi i 2 prillit, edhe hiq pa fjalë, tani duhet të kuptohet mirë

dhe drejt, brenda dhe jashtë, seriozisht.

Asgjë në kundërshtim me dëshirat e thella të Kosovës nuk do të zgjasë në pafundësi.

Prej 3 prillit nuk fillon gjyqi kundër luftës sonë, por i gjykatës kundër vetvetes dhe kësaj farës jugosllave që përfitoi përkohësisht me ndihmën e kësaj gjykate.

Do t'i mbrojmë vlerat tona të lirisë dhe pengjet e Hagës do të kthehen triumfatore.

Respekt për civilizimin e marshit dhe për organizatorët dinjitozë!



Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi nisin sot betejën për mbrojtjen e UÇK-së

Katër drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, sot (e hënë) në orën 9:00 do ta nisin betejën e tyre ligjore në Gjykatën Speciale, ku nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) akuzohen kinse për krime luftime. Ky proces gjyqësor është paraparë të jetë maratonik.

Gjykata Speciale të dielën ka lëshuar një komunikatë për medie lidhur me procesin gjyqësor që do të fillojë sot, duke bërë me dije se janë planifikuar që deklaratat hyrëse për rastin

në fjalë të mbahen më 3, 4 dhe 5 prill, duke filluar prej orës 9:00 të mëngjesit. "Duke filluar më 3 prill, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) do ta bëjë deklaratën hyrëse dhe për këtë qëllim i janë caktuar më së shumti 5 orë. Më tej është planifikuar që mbrojtësi i viktimave do ta bëjë deklaratën e tij hyrëse që do të zgjasë më së shumti 45 minuta. Pas mbrojtësit të viktimave, do të bëjnë deklaratat hyrëse secili prej katër ekipeve të mbrojtjes. Është planifikuar që këto deklaratat të bëhen më 4 prill", ka njoftuar

Specialja.

Ndonëse, Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë në Hagë që nga nëntori i vitit 2020, ata sot (e hënë) do të dalin para trupit gjykues për t'u përgjigjur për të gjitha pikat e aktakuzës me të cilat është duke i ngarkuar ZPS-ja.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi në fillim të seancave parapërgatitore në Gjykatën Speciale janë deklaruar të pafajshëm për katër akuza për krime luftime dhe gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit.

Më 9 nëntor 2020, në paraqitjen e parë para Gjykatës Speciale, Thaçi ishte deklaruar i pafajshëm për të gjitha akuzat që rëndojnë ndaj tij. "Deklarohem i pafajshëm për të gjitha pikat e akuzës", kishte thënë Thaçi, duke e cilësuar aktakuzën ndaj tij "të paqëndrueshme".

Edhe Kadri Veseli më 10 nëntor 2020 ishte deklaruar i pafajshëm për të gjitha akuzat. "I dëgjova dhe i kam lexuar të gjitha pikat e aktakuzës. Më lejoni të deklarohej me bindje të plotë, se jam tërësisht i pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës", ka

thënë Veseli.

Kurse Rexhep Selimi në paraqitjen e tij para Speciales më 11 nëntor ishte është shprehur i bindur se procesi gjyqësor do të tregojë se ai dhe UÇK-ja "nuk kemi të bëjmë asgjë me krime e as me ndërmarrje të përbashkët kriminale siç cilësohemi padrejtësisht në këtë aktakuzë". "Unë jam veç një çlirimtar që luftën për liri e kam nisur me komandantin legjendar Adem Jasharin dhe e kemi përfunduar me gjeneralin (Wesley) Clark, me NATO-n", ka deklaruar ai.



Hoti ironizon me caktimin e guvernatorit të BQK-së: Hap pas hapi drejt pozitës, urime!

PRISHTINË, 2 PRILL - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka ironizuar me vendimin e Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës që kryetari i tij, Bashkim Nurboja, të emërohet ushtrues detyre i guvernatorit të BQK-së.

Në "Facebook" Hoti ka treguar procedurat deri te caktimi i Nurbojes në këtë pozitë në njërin prej institucioneve

kryesore financiare në vend. Ai ka thënë se zgjedhja e zëvendësguvernatorit është bojkotuar gjatë tërë vitit 2022 dhe, si rezultat, "BQK mbeti pa zëvendësguvernator, i cili në mungesë të guvernatorit do të ushtronte detyrën e Guvernatorit". "Procesi i zgjedhjes së guvernatorit të Bankës Qendrore u cenua me veprime joligjore nga ana e disa anëtarëve të panelit

përzgjedhës. Si rezultat, Komisioni për Buxhet i Kuvendit të Kosovës nuk mundi ta përcjell listën me propozime në seancë të Kuvendit për votim", ka shkruar Hoti. Sipas tij, ushtruesja e detyrës e zëvendësguvernatorit "duket se është shkarkuar këto ditë për t'i hapur rrugë kryetarit të Bordit të Bankës Qendrore ta marrë detyrën e guvernatorit. Urime!".



Inflacioni i Eurozonës bie ndjeshëm në muajin mars

- Çmimet e ushqimeve u rritën edhe pse kostot e energjisë shënuan rënie

BRUKSEL, 2 PRILL - Inflacioni i Eurozonës ka rënë ndjeshëm, në nivelin më të ulët të një viti, por çmimet e ushqimeve u rritën edhe pse kostot e energjisë u ulën. Çmimet e Harmonizuara të Konsumit patën një rritje vjetore 6.9 për qind në muajin mars nga 8.5 për qind një muaj më parë, duke arritur nivelin më të ulët që nga shkurti 2022.

Rënia, e shkaktuar nga rënia 0.9 për qind e çmimeve të energjisë, ishte më e madhe se parashikimet e ekonomistëve të cilët prisnin se inflacioni i marsit në Eurozonë do të ulej në 7.1 për qind. Kjo shifër do t'i forcojë kërkesat për Bankën Qendrore Evropiane për ta ndaluar rritjen e normave të interesit, tashmë në nivelin më të lartë që nga kriza financiare e vitit 2008. Trazirat e muajit të kaluar në

sektorin bankar kanë rritur perspektivën e një krize kredie, që mund ta frenojë inflacionin dhe rritjen ekonomike në muajt e ardhshëm. Megjithatë, zyrtarët e BQE-së kanë sinjalizuar se ka të ngjarë të vazhdojnë t'i rritin normat në takimin e tyre të ardhshëm të politikave në maj nëse nuk përkeqësohen trazirat bankare.

Rënia e inflacionit total erdhi pavarësisht një përshpejtimi të mëtejshëm të ritmit të rritjes së çmimeve për ushqimet dhe shërbimet.

Inflacioni bazë, i cili përjashton kostot e energjisë dhe ushqimit, për të dhënë një pamje më të mirë të presioneve kryesore të çmimeve, arriti një nivel të ri të lartë të Eurozonës, prej 5-përqindësh në mars nga 5.6 për qind muajin e kaluar.



Banka UBS mund të shkurtojë një të tretën e vendeve të punës



BERN, 2 PRILL - Banka UBS pas blerjes së "Credit Suisse" është gati ta shkurtojë fuqinë e saj punëtore deri në 30 për qind. Siç raporton e përditshmja zvicerane "Tages-Anzeiger", duke cituar një menaxher të lartë të UBS-it, shkurtimi do të përfshijë rreth 11 mijë vende pune në Zvicër.

UBS është pajtuar ta blinte rivalin "Credit Suisse" për mbi 3

miliardë euro në një marrëveshje të krijuar nga Qeveria e Zvicrës, Banka Nazionale dhe Rregullatori i Tregut (FINMA) për të shmangur një "shkrirje" në sistemin financiar të vendit. Mirëpo, marrëveshja e cila u krijua për të ndihmuar në sigurimin e stabilitetit financiar në botë ka ngritur shqetësime për madhësinë e një banke të re

me 1.6 trilion dollarë aktive dhe më shumë se 120 mijë punëtorë në mbarë botën.

"Punët në degën e saj në ShBA do të preken gjithashtu", thuhet në raport.

UBS kishte vendosur në negociatë një marrëveshje që do t'i jepte treguesit të "Wall Street", Michael Klein, kontrollin e pjesës më të madhe të bankës së investimeve "Credit Suisse".

Tahiri i AAK-së: Sistemi i pagave në katrahurë

Prishtinë, 2 prill - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, ka thënë se sistemi i pagave është në katrahurë. Sipas tij, mijëra zyrtarë publikë, edhe dy muaj pas, nuk e dinë sa i kanë pagat, kush merr shtesa, në cilin rangim janë. "Kjo jo vetëm se ka sjellë paqartësi, pabarazi, por ka krijuar pasiguri të madhe te zyrtarët publikë. Në çdo institucion publik është krijuar atmosferë

e zymtë. Diskutimi kryesor është sa është paga. Pakënaqësi e dëshpërim. Vendimmarrësit në vend se ta shtrijnë komunikimin, kanë vendosur nga muaji në muaj të nxjerrin një arsyetim", ka thënë ai.

Tahiri ka theksuar se në këtë krizë, përtej halleve ditore, kjo paqartësi është nënvlerësim i punës, e këtu më së shumti preken profesionistët që po zgjedhin ta lënë sistemin

publik. "Për të arritur një nivel të tillë përgatitje duhen 3-5 vjet e ka raste si në shëndetësi deri në 6-10 vjet, që i bie se ne po rrezikojmë funksionet vitale të sektorëve. Me urgjencë duhet të procedohen pagat sipas ligjit, të vendoset komunikim e dialog për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit e për të parë presionin që po vjen nga trendi i largimit të profesionistëve", është shprehur deputeti Tahiri.



AJAZ EMINI - Ditar (VII)

NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

E martë, 08 qershor 1999

Sot kishim një ditë të bukur, me diell dhe të nxehtë, sa për nga arena politike nuk ishte aq e frytëshme. Edhe pse kishin filluar bisedimet për marrëveshje në mes të komandës së forcave aleate të NATO-së dhe asajë jugosllave ende nuk kishte asgjë të re.

Gjatë bisedimeve të grupit G-8, kishin bërë disa lëshime për palën e armikut jugosllav në lidhje me Kosovën. Aty ishte bërë lëshimi se poqëse marrin pjesë edhe trupat paqëruejtëse ruse, ata do të mundën që të jenë nën komandën e OKB-së e jo siç ishte planifikuar që edhe rusët me qenë nën komandën e Shtabit të NATO-së.

Ky lëshim nuk i kishte pëlqyer aspak lidërshiptit amerikan, të cilët me këmbëngulje ishin që edhe trupat ruse për të qenë nën komandën e Shtabit të NATO-së, kërkesë e cila tani u ndryshua. Tani edhe trupat paqëruejtëse ruse do t'i nënshtrohen urdhërave të Shtabit të NATO-së, si dhe të mos kenë teritor në Kosovë të ndarë për to siç iu kishte caktuar dhe dhënë forcave të tjera!

Edhe sot deri vonë, nuk patëm aq shumë punë, për shkak se Gjenerali Lama ende ishte në vizitën e tij disa ditësh në Tropojë, Bajram Curr si dhe duke i vizituar trupat e UÇK-së edhe në malet e Pashtrikut.

Dikur, më vonë morëm lajmin se aty rreth orës 19:00 nga Shtabi Ushtarak i Rinasit do të na vijë në vizitë Gjenerali John Hendrix, i cili po vinte në Kukës që të takojë Gjeneralin Kudusi Lama, si dhe na lajmëruan se edhe Gjenerali Lama po kthehej për në Kukës dikur gjatë pasditës së sotme, para se të mbërrinte Gjenerali Amerikan Hendrix që të takohen në mes veti gjatë kësajë mbrëmjeje. Tani meqenëse ata po vinin te ne, ne i bëmë një ofertë që të vijnë edhe në darkë, por këtë ofertë na e refuzuan që të dy Gjeneralët sepse i dinin kushtet dhe mundësitë tona që ne nuk kishim kushtet që të përgadisim darkë për rreth 15 mysafirë! Edhe pse takimi ishte caktuar për në orën 19:00 të mbrëmjes, nga Shtabi në Rinas na paralajmëruan se Gjenerali Amerikan do të kishte vonesë në nisje. Rreth orës 23:00 përsëri na lajmëruan nga shtabi se Gjenerali Hendrix tani sa ishte nisur dhe pas orës 23:00 ia arritën si zakonisht me helikopter. Po në të njëjtën kohë nga ana tjetër arriti edhe Gjenerali Kudusi Lama. Pas përhëndetjeve që të dy menjëherë filluan mbledhjen e tyre e cila zgjati deri në orën 1:30 pas mesnate. Këto bisedime, në përgjithësi ishin sqarime në lidhje me pikat e "Marrëveshjes Teknike Ushtarake të Kumanovës", e cila po mbahej në mes të Gjeneralëve të forcave aleate të NATO-së dhe atyre jugosllave. Pas këtij takimi i përcollëm që të dy Gjeneralët dhe ne ramë në gjumë.



"Situata operative e orës 13:40 e datës 08-06-1999 (Informacioni original i ardhur nga Shtabi i UÇK's, kordinatat mbeten konfidenciale AE)

Informacioni për armikun

A) -NATO mundë të godasë këto objektiva:

- Plafi i Kuronës
- Binaj
- Rrugën Goden-Kuronë
- Goden
- Në afërsi të Godenit
- Në afërsi të Çanakit

Në këto koordinata janë përqendruar forcat e motorizuara, të mekanizuara, tanket, mortajat dhe këmbësoria, policia speciale dhe forcat paramilitare.

Nga Plafi i Kuronës në drejtim të Gjakovës është i mbushur plotë me forcat e këmbësorisë së motorizuar të armikut.

Në dy rrugët nga Godeni në drejtim të kufirit të Shqipërisë janë përqendruar forcat e mekanizuara

B) -Në Lumbardh pas sulmit të forcave të NATO-së ne zurëm një kamion të forcave serbe dhe municion të kalibr 12.7 mm. me disa dokumente.

Në Rekën e Kuqe është koncentruar maqinaria serbe në drejtim të Lumit Erenik për Nivokaz.

Në kodrat e Prilepit, në mes të Drenovcit dhe Prilepit rreth 100 metra mbi rrugë është një bateri e artilerisë me artileri 122 mm. të cilët po gjuajnë në drejtimin tonë. Nga ky sulm neve humbëm 1 eprorë (eporin; Enver Dobra) dhe 3 ushtarë të plagosur.

Në Pozar dhe Irzniq armiku është përfurcuar me forcat e motorizuara dhe të mekanizuara me autobllinda, artileri dhe mortaja mbrenda kanalit të ujitjes."

Informacionet e 24 orëve të fundit

Aviacioni i NATO's deri më tani kishin bërë më tepër se 34,000

fluturime, dhe duke qëlluar 490 caqe dhe 520 caqeve taktike gjatë Operacionit të Forcave Aleate.

Gjatë 24 orëve të fundit me shkëputjen e palës jugosllave nga bisedimet e marrëveshjes teknike ushtarake, forcat e aviacionit të NATO-së e rritën akcionin e tyre kundër caqeve të forcave serbe. Ata arritën rekordin e sulmeve me mbi 600 mbrenda 24 orëve, dukeufokusuarkryesisht mbi forcat jugosllave gjithandëj ku po sulmonin forcat e UÇK-së.

Bombarduesit e mëdhenjë B-52 edhe B-1, edhe ato morën pjesë gjatë këtyre bombardimeve për rreth kufirit të Shqipërisë duke iu shmangur në maksimum popullatës civile. Pentagoni nuk mundi që ta konfirmojë përdorimin e armëve kimike nga forcat jugosllave që u tha më parë. Diplomacia e ministrave të G8 gjatë mbledhjes së sotme në Gjermani u pajtuan në draftin e rezolutës se OKB-së për Kosovën. Në përgjithësi ishin pajtuar që të gjitha palët përveçse asajë ruse e cila po insistonte gjithësesi që të ndërpriten sulmet e NATO- së.

James Rubin, Zëdhënësi i Departmentit të Mbrojtjes tha se drafti rezoluta i përmbahet tërësisht kërkesave tona, që i detyron që të gjitha forcat paqëruejtëse në Kosovë të mbeten nën komandën e NATO-së, si dhe bombardimet do të ndërpriten vetëmse atëherë kur forcat jugosllave fillojnë tërheqjen e tyre nga Kosova.

U raportua edhe për bisedën e Presidentit Rus Yeltsin me Presidentin Kinez Zemin në sqarimin e rezolutës nëpërmjet telefonit.

Gjithashtu edhe lideri i shqipëtarëve të Kosovës Ibrahim Rugova kishte thënë se ai do të takohet me liderët e UÇK-së së shpejti për të biseduar për gjendjen në teren.

Sipas UNHCR -së në rajon tani kishim 782.300 refugjatë, edhe atë në Shqipëri kishim 444.000 refugjatë, në Maqedoni 247.000 refugjatë, në Mal të Zi 69.600

refugjatë dhe në Bosnje dhe Hercegovinë 21.700 refugjatë.

Gjatë ditës së sotme edhe Sekretarësia e SHBA- së ishte takuar me Hashim Thaçin, Ibrahim Rugovën dhe Rexhep Qosjen në lidhje me vetëqeverisjen e Kosovës. Gjithashtu edhe lideri i UÇK-së Thaçi kishte thënë se forcat e UÇK-së nuk do të sulmojnë forcat e armikut për derisa ato do të tërhiqeshin nga Kosova. Sekretarësia Albright kishte thënë se me hyrjen e forcave paqëruejtëse të NATO-së në Kosovë edhe UÇK-ja u pajtua se do të bëjnë demilitarizimin e tyre. Presidenti Clinton tha se tani do të dërgonte edhe

4.000 trupa shtesë në Shqipëri për të lehtësuar ndihmën dhe tani SHBA kishte arritë në 10.000 trupa paqëruejtëse që do të vendoseshin në Kosovë...

E mërkurë 09 qershor 1999

Meqenëse mbrëmë qendruam deri vonë me gjeneralët, Hendrix dhe Lama, sot u zgjuam pakë më vonë se zakonisht. Diku rreth orës 16:00 pas dite ndëgjuaam përsëri kristmat e bombardimeve të aviacionit të NATO-së, ndoshta edhe më tepër për shkak të mosnënshkrimit të marrëveshjes nga pala jugosllave, e cila kishte kërkuar më tepër kohë që të konsultohen me kërret e tyre në Beograd.

Gjatë këtyre bombardimeve përsëri po përdoreshin edhe bombarduesit më të mëdhenjë që kishte aleanca e NATO-së, siç ishin bombarduesit Amerikan B-52 Stratofortres, B-1 Lancer dhe bombardues të tjerë, të cilët armikut i shkaktuan dëme shumë të mëdha në personel dhe mjete ushtarake. Për këtë marrëveshje nuk ishte i kënaqur as Gjenerali Amerikan Hendrix, sepse sipas tij njerëzit siç ishte Presidenti Slllobodan Millosheviq si dhe udhëheqësia jugosllave, ata duhej shqelmuar dhe shkatërruar tërësisht, dhe pa kurrëfarë

mëshire. Duhej shqelmuar pikërisht për të gjitha mizoritë që i kishin shkaktuar këtijë populli të pa mbrojtur dhe të pa fajshëm, dhe për të gjitha ato krime, tortura, dhunime, djegie, dëbime dhe maltretime që i kishin sjellur popullit shqipëtarë. Po, sepse ata ishin edhe shkaktarët e shumë luftërave në ish Jugosllavi!

Në orën 9:30, unë dhe kapiteni Wiggis shkuam për të takuar në zyrën e tij Gjeneralin Lama, dhe për t'ia kthyer disa dokumente nga UÇK-ja që i kishim marrë vonë në mbrëmje nga vetë ai. Gjatë takimit u furnizuaam edhe me listën e objektivave të reja, gjithashtu biseduam edhe për situatën nga fronti në mbrendësinë e Kosovës.

Për shkak të mosnënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës nga pala serbo jugosllave, tani forcat e NATO-së kishin ndërmarë aksionin që të përdorin të gjitha forcat dhe arsenalin më të rëndë që kishin në dispozicion nga aviacioni i NATO-së. Ata ndërromorën sulmin për trupat jugosllave kudo qofshin mbrenda Kosovës që të sulmohen sa më brutalisht! Sot përsëri u përdorën bombarduesit e mëdhenjë si: B-1 dhe B-52 të cilët bartnin secili nga 50 bomba Mk-82, e që secila peshonte 225 kg., si dhe municionet tjera. Këto bombardime, siç po shihej nga terreni e gjuhëzuan palën e armikut, e cila po përjetonte humbje të pa imagjinueshme, shumë të mëdha. Sipas informacioneve nga terreni, morëm vesh se nga bombardimet e sotme, derisa po sulmonim me bombarduesit B-52 diku në afërsi të kufirit të Shqipërisë, në shtatjet e malit Pashtrik u zunë të hapur 2 Batalione Jugosllave, të cilët pësuan humbje të mëdha në ushtarë dhe mjete luftarake. Nga këto bombardime thuhet se nga pala serbe pati 400-800 ushtarë të vrarë.

Në orën 21:40 të mbrëmjes na mbërriti një mesazh nga Gjenerali John Hendrix, e që për menjëherë duhej t'i dërgohej Gjeneralit Kudusi Lama në lidhje me Marrëveshjen e Kumanovës, e cila sapo ishte nënshkruar edhe nga pala serbo jugosllave, lajm të cilin grupi ynë nuk e pritëm aq me entuziazëm, sepse me këtë nënshkrim siç po shifet po i vinte edhe fundi i detyrës tone të shejtë në çlirimin e Kosovës!

Me të marrë lajmin unë dhe kapiteni Wiggis u nisëm rrugicës në këmbë, teposhtëzes për në zyrën e Gjeneralit Lama, atje ku edhe arritëm pas vetëm disa minutash. Me të hyrë mbrenda zyrës së Gjeneralit Lama, i spjeguaam për përmbajtjen dhe nënshkrimin e Marrëveshjes Teknike Ushtarake të Kumanovës, si dhe i treguaam se ajo marrëveshje na qenka nënshkruar tani edhe nga pala serbo jugosllave.

Gjeneral Lama nuk e priti aspak mirë këtë lajm të nënshkrimit të marrëveshjes së paqes, dhe nuk u ndi aspak i kënaqur me të. Nuk

ishte i kënaqur sepse tani duhej ndërprerë bombardimet. Ai madje nuk kishte kurrëfarë besimi në palën serbo jugosllave, si edhe dëshira e tij ishte thuajse ishte e njejtë me atë të gjeneralit Amerikan Hendrix. Nuk ndihej i kënaqur përderisa nuk ishin shkatërruar tërësisht forcat e armikut kriminel serb, për të cilët asnjëri prej tyre nuk kishte kurrëfarë mëshire.

Pas sqarimit të marrëveshjes dhe bisedës së lirë që patëm dikur në orën 22:15 të mbrëmjes, përsëri u nisëm po të njejtës rrugicë në këmbë për t'u kthyer në zyrën tonë në godinën e Policisë Ushtarake të Shqipërisë. Rrugica nuk kishte kurrëfarë drite, si dhe kjo natë ishte shumë e errët edhe pak e freskët, dhe derisa ne po ngjiteshim përpjetë bregores diku nga gjysma e rrugës përmenjëherë filloi rrebeshi i gjuajtjeve me llojloj arsenalesh, nga të gjitha anët e Kukësit!

Tani i gjithë qielli u ndritë nga arsenalit flakadan i shqiptarëve që po festonin, pamje që më përkujtonte shumë Festën e 4 korrikut, Ditën e Pavarësisë së Amerikës që e kisha përjetuar tani për shumë e shumë vite që kur po jetoja në Amerikë. I tërë qielli ndritej nga fishekëzjarret e ndryshëm që i dhezën në ajër! Kjo që po ndodhë tani sigurisht se na qenka pas marrjes së lajmit të mirëpritur nga i gjithë njerëzimi. Sigurisht prej lajmeve nga mediat shqiptare për nënshkrimin e marrëveshjes së paqes, e që tani e gjithë popullata po festonin "DORËZIMIN" e palës serbo-jugosllave. Po gjuhej me të madhe edhe nga çadrat e refugjatëve kosovarë që i kishim afër, e që shumica e refugjatëve që ishin të strehuar në çadrat afër neshë po festonin se tani edhe ato do të mundë të kthehen në shtëpitë e tyre. Po, edhe atë pa ballafaqime me gjakpirësarë dhe kriminelët paramilitarë-ushtarak-policor serb. E gjithë hapsira qiellore e Kukësit tani po dukej po sikur të jetë pushtuar nga shiu meteorik!

Pas disa minutash arritëm në zyrën tonë dhe menjëherë Kapitani Wiggis i telefonoi Gjeneralit Hendrix për t'i tregu për dorëzimin e mesazhit të tij, si dhe për t'i treguar se si e pritni lajmin e marrëveshjes edhe Gjenerali Lama gjatë takimit me ne. I tregoi edhe për mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e Gjeneralit shqiptar, sepse Gjenerali Hendrix kishte shprehë gadishmërinë që për çfarëdo mosmarrëveshje që do të ndodhë, ai ishte i gatshëm që në çfarëdo kohe që të vijë në Kukës dhe të takohet me Gjeneralin Lama, sa për t'i sqaruar atij personalisht.

Tani gjithëçka ishte mëse e qartë, se edhe kësajë lufte tani i kishte ardhë fundi.

Por sa ramë me fjetë, në orën 24:00 të mesnatës, njëri nga oficerët e zyrës së Policisë Ushtarake të Shqipërisë, e cila ishte po në të njejtën ndërtesë ku ishim vendosë edhe ne, erdhi edhe më zgjoi mua, duke më thënë: "Gjenerali Lama po të thërret në telefon, dhe duhesh të vishë urgjentisht tani për menjëherë". I habitur dhe përgjumshëm menjëherë shkova në zyrën e tyre edhe e kapa

telefonin, nga ana tjetër e telefonit për menjëherë e ndëgjova zërin e Gjeneralit Lama i cili sipas zërit të bisedës ishte mjaftë i mllefosur! Disi filloi duke e ngritë zërin edhe të më bërtasë, edhe nuk po ndalej dot. Unë për vete nuk isha mësuar që të ndëgjoja ndonjërin të më bërtasë kështu, mirëpor e mbajta veten dhe e ndëgjova deri në fund me shumë gjakftohtësi. Po, sepse e njihja shumë mirë Gjeneral Lamën me të cilin kishim kaluar një kohë të gjatë në Kukës nën kujdesin e tij. Po, për më tepër se një muaj dhe gjithëmonë kishte qenë shumë korrekt ndaj të gjithë njësive tonë, e në veçanti ndaj meje dhe kapitenit Wiggis! Thuajse gjithëmonë me mua dhe kapitenin gjatë tërë kësajë kohe sa ishim këtu në Kukës dhe të takimeve të përditëshme, edhe nganjëherë edhe disa herë në ditë. Kishim bërë një marrëdhënie të besueshme me të, dhe shumë vëllazërore. E lashë të shfryhet njëherë për derisa e kreu të tërë atë mllef, dhe kur ndaloj së bërtituri, unë ia ktheva me fjalë të buta: "Po pse po më bërtet kaq shumë i dashur dhe i respektuar Gjeneral Lama?! Çka ju bëra aq keq që po shprehë të tërë këtë mllef ndaj meje?! A thua çfarë faji paskam bërë unë?! "Gjenerali për menjëherë ndaloi dhe u pendua pa masë, edhe ma priti: "Jo or biri im, por ajo Sebi përkthyesja e Gjeneralit Hendrix më ka nevrkosë pa masë. Ju duhet ta dini se sa e rëndësishme është puna juaj. Nuk bënë dhe nuk guxon të lejohet që dikush që nuk i njeh gjuhët shumë mirë, të bëjë punën e përkthyesit. Kërkoj nga ju që në takimet e ardhëshme me qenë edhe ti prezent me ne, sepse ne duam që të kuptohemi sa më mirë se për çka po flasim me Gjeneralin Hendrix, e jo që ajo të më flasë më tepër anglisht duke menduar se edhe unë po e kuptoj atë se çka po më thotë.

Problemi kishte qenë se Gjenerali Hendrix me përkthyesin e tij e kishin telefonu Gjeneralin Agim Çeku të UÇK-së, për t'ia lexuar dhe sqaruar "Marrëveshjen Ushtarako Teknike të Kumanovës" të sapo nënshkruar nga të dy palët: ajo e NATO-së dhe serbo-jugosllave. Pas përfundimit të bisedës së tyre, Gjeneral Çeku menjëherë i kishte telefonu Gjeneralit Lama, edhe iu kishte anku se nga ajo telefonatë e Gjeneralit Hendrix nga Shtabi i Armatës Amerikane në Rinas në lidhje me marrëveshjen, nuk kishte mundë të arrijë që të kuptojë asgjë nga Sebi, përkthyesja e Gjeneralit.

Gjenerali Lama më porositi që menjëherë t'i telefonojmë Gjeneralit Hendrix edhe t'ia sqarojmë problemin, dhe t'i themi që përsëri ai t'i telefonojë direkt Gjeneral Çekut edhe t'i flasë atij në gjuhën Angleze, sepse ai e njeh shumë mirë edhe Anglishten. Pasi të kryejnë bisedën, ata të Gjeneralit Hendrix të ju marrin në telefon përsëri juve, dhe me iu treguar juve se si rrodhi biseda. Dua të dijë se a u kuptuan mirë në mes vete. Pastaj ti më merr mua në telefon përsëri që të më tregosh se si ka rjedhë biseda, edhe atë pa marrë parasysh kohën. Më telefono mua që ta dijë se a janë kuptuar mirë në mes tyre apo jo. Për këtë porosi mu desht që të



23 Nëntor 1999, Sojevë / Kosovë, Shahadija me Sekretaren e SHBA's Madeleine Albright në Kampin Ushtarak Amerikan "Bondsteel", Sojevë

presim deri në orën 2:30 pas mesnate, atëherë kur na telefonoi përsëri Gjeneralit Hendrix dhe na tregoi për bisedën e tyre të frytëshme që kishin patur nga mënyra direkte e bisedës dhe e sqarimeve të marrëveshjes me Gjeneralin Çeku.

Menjëherë me të marrë lajmin i telefonova Gjeneralit Lama edhe i spjegova pikërisht për telefonatën e Gjeneralit Hendrix për atë që na tha, se biseda e tyre gjithëçka kishte shkuar në rregull. Për këtë Gjeneralit Lama iu bë qejfi, dhe më tha se: "Tani që të gjithë jemi mirë, sepse nuk mundesha të qetësohem pas asajë se ç'kishte ndodhur më herët me përkthimin që ia kishin bërë". Pastaj u morëm vesh që përsëri nesër (d.m.th. sot), dikur para dite që të takohemi përsëri si ditëve të tjera në zyrën e tij dhe të shqyrtonim pikat tjera vijuese. Po, edhe për të marrë listën e objektivave të reja për çfarëdo rasti po qëse shkelen rregullat e marrëveshjes, për të cilën marrëveshje ishte shumë skeptik.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Mbrenda 24 orëve të fundit kishte mbi 523 fluturime, me 130 caqe të qëlluara kundër forcave ushtarake të ish Jugosllavisë.

Pentagoni kishte lajmëruar se po shifeshin përgaditjet e forcave jugosllave për tërheqjen e tyre prej Kosove.

Pentagoni raportoi se siç po shihet nga terreni, forcat serbe po përgaditen të terhiqen nga Kosova, si dhe marrëveshja e paqës është arritë në mes përfaqësuesve të NATO-së dhe përfaqësuesve të ish Jugosllavisë.

Anëtarët e G 8 gjithëashtu u pajtuan në draft rezolutën e OKB-së për Kosovën, ku Kapitulli VII i OKB's e cila lejon prezencën e një grupi ndërkombëtarë të sigurisë, si dhe i garanton tërheqjen e sigurtë të trupave jugosllave si edhe kthimin e vetëm një numri të caktuar të tyre në Kosovë. Forcave

të ish Jugosllavisë iu dha vetëmse 7 ditë kohë për t'u tërhequr nga Kosova si dhe ndërprerjen e të gjitha aktiviteteve të tyre, si dhe pajtimin e formimit të një tribunali për krimet e kryera. Gjithëashtu u bë marrëveshja edhe për demilitarizimin e UÇK-së, si dhe iu dha shqiptarëve e drejta e një autonomie substanciale për të vetëqeverisë me vendin e tyre, por me ndihmën e personelit të OKB-së.

Pas shpalljes së marrëveshjes së rezolutës, Ministri i Punëve të Jashtme të Rusisë Ivanovi dhe Sekretarësha e Shtetit të SHBA-së Albright biseduan rreth sqarimit të interpretimit të marrëveshjes ku Ivanovi kishte thënë se ndoshta Rusia do të dërgojë deri në 10.000 trupa të sajë në Kosovë. Por, ato trupa të mos jenë nën komandën e NATO-së, mirëpor për çfarëdo aspekti ne do të mirremi vesh në mes veti, kurse Albright në këtë kontrast tha se NATO-në do të jetë ajo që udhëheqë me KFOR-in si dhe ajo do të komandojë operacionet! Nga ana tjetër Kina kritikoi pjesën e rezolutës për bashkëpunimin e KFOR-it me tribunalin e krimeve, si dhe statusin e ardhshëm të Kosovës e cila minon integritetin territorial të shtetit jugosllav.

Gjatë ditës së sotme përsëri kishin vazhduar bisedimet në mes të gjeneralëve të NATO-së edhe atyre jugosllav në termat "tekniko-ushtarakë", pas ndërprerjes disa orëshe të delegatëve jugosllav të cilët shkuan për t'u konsultuar me Beogradin. Përfaqësuesi i NATO-së tha se pika kyçe e marrëveshjes kishte të bënte me sekuencat e kohës së tërheqjes së trupave jugosllave prej Kosove.

Gjithashtu sot u bë e ditur nga agjencia e lajmeve jugosllave Tanjug, se grupet e para të policisë dhe ushtrisë jugosllave ishin tërhequr nga Kosova sipas urdhërave të armatës jugosllave. Po ashtu u tha se sot edhe liderët kosovar: Hashim Thaçi i UÇK-së, Ibrahim Rugova i LDK-së dhe Rexhep Qosja i LDB u pajtuan se

do të punojnë së bashku në formimin e qeverisë së përkohëshme, në të cilën do të përfshiheshin të gjitha palët.

Sot pati edhe një kritikë nga Presidenti i Malit të Zi Milo Gjukanoviq ku e kritikoi ashpër presidentin jugosllav Slobodan Mollosheviq, i cili tha se forcat serbe gjatë tërheqjes nga Kosova të mos dërgohen në Mal të Zi.

Sipas informacionit të UNHC-së nga Maqedonia ishin evakuuar për në shtetet tjera me Aeroplan 794 refugjatë nga Kosova që na jepte numrin e të evakuarve deri më sot 79,979 refugjatë që nga 05 Prilli deri më 09 Qershor 1999. Tani mendohet se në këtë regjion kemi në total të 783,000 refugjatëve kosovarë, prej tyre në Shqipëri 444,200 refugjatë, në Maqedoni 247,400 refugjatë, në Mal të Zi 69,700 refugjatë edhe në Bosne dhe Hercegovinë 21,700 refugjatë. Sipas fjalëve të Sekretarëshës së Shtetit të SHBA-së Albright, ajo tha se drafti i rezolutës se OKB-së i përmbahet kërkesave tona të SHBA's, si dhe kërkesave substanciale të NATO's për prezencën e trupave paqëruajtëse vetëmse nën komandën NATO-së, si dhe ajo tha se trupat ruse nuk do të kenë sektor të ndarë të tyre si dhe do të jenë edhe ata nën komandën e NATO-së.

E enjte, 10 qershor 1999

Dita e sotme filloi me një tempo shumë më të ngadaltë se ditët e tjera. Në orën 11:00 para dite, pasi morëm një porosi nga Komandanti Suprem i NATO-së Gjenerali Wesley Clark për Gjeneralin Lama, menjëherë shkua që të takohemi në zyrën e tij, dhe t'ia përcjellim porosinë në lidhje me gjuajtjet e artilerisë së armikut serb për rreth zonave kufitare të Shqipërisë.

Kërkohej që këto gjuajtje të verifikohen nga vetë Gjenerali Lama, dhe pastaj përmes neve ato informata t'i dërgohen atij për menjëherë edhe atë deri në orën 11:30 para mesditës. Pikërishtë

atëherë kur Gjenerali Clark do të takohet me krerët e lartë të ushtrisë jugosllave, me kusht që edhe këto shkelje të marrëveshjes t'ia prezentojë para syve të tyre edhe palës jugosllave. Gjenerali Clark i kërkoi këto informata, sepse ushtria jugosllave ende nuk i kishte ndërprerë sulmet e saja, edhe pse marrëveshja ishte bërë për ndërprerjen e menjëherëshme të të gjitha sulmeve.

Gjatë bisedës me Gjeneralin Lama, kuptuam se forcat serbo jugosllave veçse kishin filluar tërheqjen e tyre nga Kosova, e bile gjatë tërheqjes duke kaluar nëpër Podujevë ua paskan vu zjarrin edhe disa shtëpive të shqiptarëve, duke treguar barbarizmin e tyre sllav edhe gjatë ikjes së tyre nga toka Dardane!

Gjeneralin Lama gjithashtu e njoftuam edhe për fluturimet e aeroplanëve (dronave) spiun të NATO-së pa ekuipazh, të cilët gjithnjë do të bëjnë kontrollin e zonës kufitare Shqipëri-Kosovë, dhe që janë në gjendje që të hetojnë çfarëdo prishje të armëpushimit, si dhe t'i njoftojë edhe trupat e UÇK-së, sepse edhe ata që të gjithë do të jenë në mbikqyrje nga ajri nëpërmjet dronave me kamerë. Pra, të kenë kujdes sepse rregulli i marrëveshjes vlenë për të gjitha palët, pa marrë parasysh se kush është!

Informacionet e 24 orëve të fundit

Sipas informatave të reja, përfaqësuesit e NATO-së me përfaqësuesit jugosllav nënshkruan Marrëveshjen Teknike Ushtarake (MTA) mbrëmë, duke caktuar fazat e tërheqjes së të gjitha forcave jugosllave nga territori i Kosovës, si dhe detalizimin e autoritetit të forcave paqeruajtëse të KFOR-it që do të hynte në Kosovë.

Forcat jugosllave do të fillojnë me tërheqjen e tyre në faza, dhe për t'u kryer gjerë më 20 qershor 1999. Marrëveshja e nënshkruar ushtarake e NATO-së i jep autorizim për të përdorur të gjitha forcat e tyre po që se duhet për të mirëmbajtje sigurinë në vend. Gjatë 24 orëve të fundit patëm mbi 400 fluturime të avionit të NATO-së duke bombarduar kryesisht mbi caqet serbe.

Trupat e KFOR-it Britanez do të jenë të gatshëm që të hyjnë në Kosovë që në ditën e nesërme. Kontingjentin "Task Force Falcon" të KFOR-it me pajtimin e 19 pjesëtarëve të NATO-së ishin pajtuar që të zavendësojë "Operation Allied Force" që do të përbëhej prej; 3,600 trupave (82nd Airborne dhe U.S. Marines), të cilët do të zavendësohen pas 30 ditësh nga 7,000 trupa (1st Armored Division ne Gjermani); nga 1,900 U.S. Marines që po pritnin në skelen e Selanikut ku po i pengonin demonstruesit grekë të cilët ishin kundër prezencës së tyre që të zbarkojnë në tokën greke!

Sot ishte parë konvoji i madhë i ushtrisë serbo jugosllave duke dalë jashta kufirit të Kosovës. Në ditën e sotme veçse kishin fillu edhe përgaditjet e mëdha të forcave të NATO's, nga Shqipëria dhe Maqedonia që të jenë të gatshme që në ditën e nesërme të fillojë zbarkimi i tyre mbrenda kufinjve

të Kosovës. Tani çdo gjë kishte filluar që të lëvizë në hapat e shpejtë dhe të duhur, sipas marrëveshjes që kishin bërë krerët e NATO's. Gjatë ditës së sotme u bë edhe votimi i Rezolutës së Kosovës në OKB, për të cilën ishin pajtuar që të gjithë palët përveçse Kinës e cila kishte abstenuar, për çka dihen shkaqet sepse ata kishin problemin e tyre të mbrendshëm, duke insistu se askush nuk guxon të përzihet në sovranitetin e mbrendshëm të një shteti tjetër. Kina kishte problemin me teritorret rreth sajë siç janë: Tajvani, Nepali dhe Hong Kongu.

Të njëjtin veprim do ta bënin edhe rusët, mirëpo për shkak të gjendjes së tyre të shkatërruar ekonomike, ata ishin në gjendje që të lëshonin pe gjithëkund, veçse që të kenë ndihmën e perendimit në investime në shtetin e tyre. Për Rusinë, edhe pse ajo gjithmonë kishte luajtur rolin e vëllaut të madh të Serbisë, tanimë ata kishin dhimbjet dhe problemin e vetë, dhe nuk donin që të rezikonin veten për Serbinë. Sipas informatave më të reja tani ndëgjuam se edhe në Beograd paskan fillu manifestimet e mëdha për përfundimin e luftës. Edhe atë duke e quajtur edhe Millosheviqin fitues kundër aleancës së NATO-së Diçka që më përkuajt betejën e Kosovës kundër Perandorisë Osmane, të cilën edhe sot e kësajë dite ende e festojnë si fitore të tyre, edhe pse edhe ajo ishte humbje e madhe e Serbisë! Me këtë marrëveshje Jugosllavia ishte e detyruar që të tërhiqej tërësisht nga Kosova, si dhe trupat e tyre që të zavendësohen nga trupat e armatosura të aleancës së NATO-së, që donë të thotë se marrëveshja ishte nënshkruar me të gjitha kërkesat ashtu siç iu kanë kërkuar dhe urdhëruar nga forcat e NATO-së. Sipas marrëveshjes kërkohet që një numër i caktuar policësh dhe ushtarësh të mbeten në mbikqyrjen dhe mbrojtjen e popullatës serbe, mirëpo më vonë edhe ajo nuk u mor parasysh. Pra, me një fjalë që të gjitha forcat e tyre ishin të detyruara që të largohen nga mbrendësia e Kosovës.

Për momentin, fitorja është krejtësisht në anën e shqiptarëve, mirëpo ajo që është më e

rëndësishme tani ishte problemi se si do t'i bashkojmë krerët e partive dhe rrymave të ndryshme shqiptare të Kosovës. Për derisa e gjithë shqiptaria po zvarritej për çlirim, në anën tjetër kishte edhe të atillë që po luftonin për pozita se kush çfarë pozite do të ketë. Për çka mendoj unë personalisht, se ajo punë duhet t'i mbetet popullit që të vendosë, e jo liderëve partiak!

E premte, 11 qershor 1999

Edhe sot si ditëve më të herëshme, ushtria serbo jugosllave po vazhdonte tërheqjen e trupave të tyre, dhe gjithëçka deri më tash po shkonte sipas "Marrëveshjes Teknike Ushtarake të Kumanovës", që kishin nënshkruar për tërheqje të plotë. Kësajë tërheqje nga Kosova iu bashkangitën edhe kriminelët civil serb dhe rom me familjet e tyre që ndoshta edhe ata kishin qenë të involvuar në krime ndaj fqinjëve të tyre shqiptarë. Po largoheshin më tepër nga friga e ndonjë hakmarje të familjarëve të masakruar për krimet që kishin bërë mbi popullatën e pambrojtur dhe të pafajshme shqiptare.

Meqenëse nuk ishim aq të nxanun dikur në orën 15:00 pas dite, vendosëm që unë me Kapitenin Wiggis dhe dy kolegët e tjerë Amerikan të njësisë tonë, t'i bëjmë një vizitë nga afërsia pikës kufitare në Morinë, të kufirit Shqipëri-Kosovë. Qëllimisht edhe për të parë prej së afërmi se ç'po ngjante dhe si ishte gjendja andej kufirit. Përtej kufirit po shifej se ende kishte disa trupa ushtarake serbe. Gjithashtu nga largësia pamë edhe fshatin Gorzhup, një fshat në Kosovë afër kufirit, i cili po digjej dhe ishte në flake. Diçka e tillë ishte krejtë e zakonshme, sepse aty ku kalonin serbët, ata i plaçkitnin edhe më në fundë ia venin zjarrin për t'i humbë gjurmët e tyre të kimit. Ky ishte urdhëri dhënë nga kryesia serbe-jugosllave që pas vetes mos të lënë asgjë në mënyrë normale!

Prej këndej pamë edhe Planejen dhe disa fshatra të tjerë afër kufirit, vende të cilat gjerë më tani ishin përdorë edhe si fortifikata për armikun serbo jugosllav, e që shifeshin se ishin të shkatërruara

tërësisht edhe nga bombardimet e avionit të NATO-së. Në këto vende për ku mendohet se u vranë mijëra pjesëtarë dhe u shkatërruan një numër i madh i arsenalit të armikut gjakatarë serb. Gjatë bombardimeve të këtyre fshatrave u përdor armatim i llojllojshëm nga bombarduesit e avionit të NATO-së, siç ishin nga B-52 që po gjuanin bomba deri në 1000 kg., të cilat ishin në gjendje të shkatërronin gjithçka për rreth, bile edhe në nëntokën ku ishin barikadu trupat e armikut sllav.

Pas vëzhgimit që i bëmë terrenit përsëri u kthyem në vendqëndrimin tonë. Gjatë ditës së sotme kishim edhe një lajm shumë interesant. Po, për dislokimin e një njësie ruse nga Bosna dhe Hercegovina e cila pa pyet askend kishte ardhë në Prishtinë, aty ku në fillim, atëherë kur gjithëçka ishte konfuze dhe ishte pritur në mënyrë madhështore nga serbët lokal të Kosovës. Ishin pritur si vllëzërit e mëdhenjë të tyre, dhe pastaj kishin vazhduar dhe ishin futur mbrenda në aeroportin e Slatinës. Pa lejen e Shtabit të NATO-së

Kjo na ishte një çmenduri ruse që askujt nuk i kishte shkuar mendmend se do të ndodhëte ashtu, por që nuk është për t'u çuditur me to.

Nga marrëveshja ushtarake e NATO-së kjo zonë ishte caktuar që të jetë nën kontrollin Britanez, të cilët ishin në rrugë e sipër nga Maqedonia për në këtë vend ku veçse njësisia ruse ishte vendosur aty, e që kuptohet sigurisht se për qëllimet e tyre strategjike.

Deri sa po çlodheshim, gjatë mbrëmjes së sotme në orën 22:00 ndëgjuam një eksplozim. Mbrenda disa sekondash menjëherë na lajmëruan nga Policia Ushtarake e Shqipërisë që kishin zyrën në anën tjetër të ndërtesës ku ishim ne, për një aksident të një aeroplani Britanez që sapo kishte ndodhur. Ai gjatë ngritjes së fluturimit nga aeroporti i saponjëruar i Kukësit (aeroporti i cili sapo ishte rindërtuar nga Emiratet e Bashkuara Arabe) kishte ra edhe kishte filluar të digjej. Kjo ngjarje që ndodhi ishte krejtësisht afër nesh, në një

distancë më pakë se një kilometër. Me të ndëgjuar për ndodhinë, njoftuam Shtabin në Rinas dhe i kërkua ndihmë për të shpëtuar ekuipazhin e aeroplanit, dhe menjëherë u nisën për t'i dalë në ndihmë, kurse mua më lanë që të presë me një bateri sinjalizues në dorë për të pritë helikopterët që i kishim kërkuar për ndihmë nga Shtabi i Rinasit. E që kur të arrijnë, unë t'i japë atyre shenjë me atë lloj baterie për vendin e aterimit në oborrin tonë. Aeroplani kishte pasë rënë jashtë rrethojës me tela gjembash të pistës së aeroportit të Kukësit, dhe nuk ishte aspak larg nga çadrat e refugjatëve të Kosovës, në një distancë rreth 200-300 metrash. Ishte fat që kishte rënë pakë më largë prej çadrave, se për ndryshe do të kishte shkakuar një tragjedi të madhe njerëzore me pasoja shumë të mëdha. Po, pasi se aty ishin të strehuar me mijëra refugjatë të Kosovës. Pasi arriti në vendngjarje njësisia jonë atje, gjeti aeroplanin të mbuluar tërësisht në flakë, ku menjëherë kishin arritë që të evakujnë të tërë personelin njerëzorë prej 12 vetash së bashku me ekuipazhin që kishin qenë në aeroplan. Ishte një fat dhe falë ndihmës së Njësisë Speciale të Armatës Amerikane që ishim në Kukësi që me shumë sukses i shpëtoi që të gjithë ata që kishin qëlluar në atë Aeroplan përveçse disave që kishin pësuar lëndime trupore. Në ndihmë për evakuim erdhën edhe 3 helikopterët "Black Hawk" të Armatës Amerikane dhe 1 helikopter i Armatës Belge, kurse ai i Armatës Franceze pasi se na thanë se po vijnë për t'i evakuar të lënduarit e aeroplanit, menjëherë na zhgënjyen sepse pas disa minutash na lajmëruan se nuk do të vijnë. Nga vendi i ngjarjes së aksidentit të lënduarit u transferuan për në spitalin e Tiranës. Për sigurinë e fluturimit të helikopterëve ushtarak gjatë ndihmës së tyre këtu në afërsi të qytetit të Kukësit, gjatë kësajë kohe na u paraqitën edhe 6 aeroplanë luftarak të NATO-së për sigurinë e helikopterëve për çfarëdo rasti, dhe të cilët ndihmuan edhe duke na e ndriçuar qiellin e errët me llojet e tyre të fishekëzjarreve (flares), të cilët i lëshonin kohë pas kohe nga një lartësi e lartë në qiell. Ky operacion i ndihmës së evakuimit të tyre zgjati për disa orë, derisa u evakuan që të gjithë të lënduarit edhe u sigurua vendi i ngjarjes së aksidentit për hetimet e më tutjeshme.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Sipas informatave të sotme të NATO-së gjerë më tani personeli prej 4,000 ushtarësh jugosllav ishte tërheqë prej territorit të Kosovës, kurse gjatë ditës së sotme gjithëashtu kishim 399 fluturime të avionit të NATO-së të cilët në përgjithësi ishin në mbikqyrje dhe vëzhgimin e trupave të armikut serb.

Gjatë kampanjës së bombardimeve 78 ditore, kishim në fluturim mbi 1,000 aeroplanë të forcave të NATO-së të cilët bënë 35,219 fluturime duke gjuajtur 23,000 municione (bomba, raketa etj.).

Gjatë ditës së djeshme kishim arritjen e 700 ushtarëve në



20 Qershor 2000, Sojevë / Kosovë, Ajaz Emini me Gjeneralin e UÇK-së Agim Cekun.

Maqedoni duke e rritë numrin e forcave të KFOR-it në 19,300 trupa. Hyrja e trupave të parë të KFOR-it në Kosovë nga Maqedonia pritej për sot, mirëpo për shkaqe të ndryshme hyrja e tyre u shty ndoshta edhe për 24 orë më vonë. Nga diplomacia kishin vazhduar edhe më tej bisedimet rreth pjesëmarrjes së trupave ruse, sepse ata ende insistonin që trupat të kenë sektorin e tyre si dhe të mos jenë nën komandën e NATO-së. Gjenerali rus Ivachov i cili ishte negociator tha: "Nëse ne nuk mundemi me ardhë deri te pajtimi me palën amerikane, ne do ta caktojmë me palën jugosllave që të kontrollojmë një sektor në vete", për derisa Talbot tha bindshëm se nuk do t'i jipet sektor në vete palës ruse për shkak se do ta çonte në coptimin e Kosovës!

Zëdhënësi i NATO-së nga forcat e SFOR-it në Bosne, lajmëroi se një kontingjent rus prej 150 trupave paqëruajtëse nga Bosna ishin nisur drejt Kosovës. Mirëpo zyrtarët rus thanë se ata do të pritin në jug të Serbisë për derisa të bëhet marrëveshja për të hyrë si trupa paqëruajtëse në Kosovë me një komandë të përbashkët...

E shtunë, 12 qershor 1999

Siç po shifet edhe sot, për neve do të jetë ditë monotone, pasi se me nënshkrimin e Marrëveshjes Tekniko Ushtarake të Kumanovës, punës tonë veçese po i numëroheshin ditët e fundit e që po vinte drejt përfundimit! Meqenëse nuk ishim të nxanun aq shumë Kapiteni Wiggis me disa pjesëtarë të grupit vendosën që sot të shkojnë për vizitë deri te kolegët e tyre. Pra tek grupi tjetër që ishin të vendosur në Krumë, kurse mua me dy pjesëtarët e tjerë na lanë që të kujdesemi nëse na vjen ndonjë send prej Gjeneralit Kudusi Lama.

Pas largimit të tyre në orën 9:00 para dite, më telefonoi Gjenerali Lama për të më bërë me dije se donte që të takohet me kapitenin Wiggis! Pasi se i tregova se ata ishin nisur për në Krumë, Gjenerali insistoi që unë të shkojë me ndonjë pjesëtarë tjetër të njësisë tonë për ta takuar atë në zyrën e tij. I tregova kolegut tim Dan, pjesëtarit tjetër i Njësisë Speciale të Armatës Amerikane që ishte me ne që nga fillimi ynë në Kukës se na duhet për t'u nisur për tek Gjenerali tani menjëherë. U nisëm dhe shkuan në zyrën e Gjeneralit Lama, ku si çdo herë edhe sot përsëri ai na priti në mënyrë të ngrohtë vëllazërore dhe shumë miqësore. Biseda ishte kryesisht për gjendjen mbrenda Kosovës. Por ajo që ishte më me rëndësi, ishte futja e trupave ruse në Prishtinë, e që sipas tij pasi se këto trupa ushtarake kishin ardhur pa kurrëfarë marrëveshje, që donë të thotë se ata duhej të konsideroheshin si trupa okupuese armike! Ky farë kontingjenti rus kishte qenë tani prej disa vitesh për ruajtjen e paqes në Bosne dhe Hercegovinë, dhe siç po shifej ata kishin lënë detyrën e tyre. Po, edhe atë pa e pyetur askënd ishin dislokuar dhe kishin ardhur në Prishtinë, e pastaj kishin vazhduar rrugën për

në aeroportin e Sllatinës ku edhe kishin bërë okupimin e tij! Ky ishte një incident që do të shkaktojë mosmarrëveshje në mes të forcave aleate të NATO-së dhe palës ruse. Biseduam edhe për tërheqjen e trupave jugosllave nga Kosova, si dhe veprimet e tyre fashiste gjatë tërheqjes duke dhezë edhe shume shtëpi të shqiptarëve. Por, edhe në shumë raste po i djegnin edhe shtëpitë e veta, e që sipas mendimit tonë ata e bënin ndoshta edhe për shkak të krimeve të bëra nga vetë ata. E tani, ata nuk mendonin që të kthehen këtu, dhe kështu që mos t'ia lënë të tjerëve për t'i shfrytëzuar shtëpitë e tyre! Nga ana tjetër ndoshta ishte që më vonë edhe të thojnë se shtëpitë e serbëve janë djegur nga forcat e UÇK-së dhe shqiptarët pas tërheqjes së tyre, që popullata serbe mos të ketë ku të kthehet më! Këto ishin vetëm mendimet tona konspirative!

Biseduam edhe për problemin e minimeve të shtëpive të vendbanimeve shqiptare, duke ia minuar dyert, dritaret, enët e kuzhinës edhe kopshtet e shtëpive. Pasi përfunduam bisedën përsëri u kthyem në zyrën tonë, ku tani po prisnim urdhërin për të ardhmen tonë si dhe çka të vepronim më tutje. Pas kthimit tonë në zyrë, Dan me shokun e tij ia transmetuan përmbajtjen e kësaj bisede edhe Gjeneralit Hendrix i cili pa kurrëfarë pritese vendosi që të na vijë tek ne në Kukës, për ta takuar personalisht ai vetë Gjeneralin Kudusi Lama. Ai na porositi që ta njoftojmë Gjeneralin se ai do të vijë te ne në orën 15:00 për t'u takuar. Në orën 15:00 pasdite, si zakonisht te ne mbërriti Gjenerali amerikan Joe Hendrix me helikopterët ushtarak, dhe po në të njëjtën kohë arriti edhe Gjenerali shqiptar Kudusi Lama. Takimi mes tyre ishte shumë miqësorë, pas përshëndetjeve dhe përqafimeve të tyre menjëherë e filluan bisedën rreth shqetësimit të tyre për hyrjen e trupave ruse në Aeroportin e Prishtinës. Pikërisht aty ku duhej vendosur Shtabin Qendrorë të aleancës së NATO's për tërë Kosovën, e që sipas marrëveshjes ushtarake ishte diçka e pa imagjinueshme për të gjithë se si një fuqi botërore do të vendosë kësajsoj kokë në vete! Sipas fjalëve të Gjeneralit Hendrix, mendohej se mos ishte bërë edhe ndonjë marrëveshje e fshehtë në mes të forcave ruse dhe asaj të ushtrisë jugosllave, që po sa të tërhiqen forcat serbe, të futen dhe të zëvendësohen me ato ruse. Ndoshta me qëllim që të mbanin pjesën e cilën edhe po ëndëronin, pra për kontrollin e Trepçës dhe disa pjesëve të tjera më të pasura të Kosovës. Apo ndoshta edhe me qëllime tjera të ndërrimeve territoriale. Sipas fjalëve të Gjeneralit Hendrix, një gjë e tillë as që vjen parasysh dhe nuk do të lejohet kurrësesi. Një gjë e tillë ne gjithnjë e kemi pritur dhe na e ka marrë mendja se do të ndodhë, sepse në të gjitha marrëveshjet ruso-amerikane, ata janë munduar që të na tradhetojnë, edhe na tha: "Ndarja e Kosovës nuk do të lejohet në asnjë mënyrë



04 Tetor 1999, Sojevë /Kosovë, me Gjeneralet e TMK-së Refki Suma dhe Shaban Shala

që të ndodhë!"

Gjatë bisedës Gjenerali Hendrix i premtoi Gjeneralit Lama se pasi se të qetësohet gjendja mbrenda Kosovës, do të dëshironte që së bashku me të të shkonin për t'a takuar Gjeneralin Agim Çeku të UÇK-së në Malishevë. Po, atje ku e kishte shtabin e UÇK-së si dhe pastaj të vizitojnë tërë Kosovën. Ai dëshironte që në rend të parë të vizitojnë dhe shtëpitë e refugjatëve të cilat tani veçese ishin të plaçkitura, të djegura dhe të shkatërruara deri në themel nga bombardimet e forcave fashiste serbe.

Gjenerali Hendrix shprehu dëshirën që gjatë vizitës në Kosovë që të vizitojnë dhe një familje Pejane që i njihje dhe kishte miqësi të mirë tani një kohë të gjatë nga vendbanimi i tij në Amerikë. Që të dy Gjeneralët ishin tepër të kënaqur për bashkëpunimin dhe miqësinë që kishin krijuar në mes vete, e sidomos edhe me suksesin dhe rezultatet në koordinimin e bombardimeve të avionit të NATO-së, aty ku vetëmse amerikanët udhëhiqnin me mbi 60% të bombardimeve mbi forcat jugosllave si dhe mbi tërë Jugosllavinë! U gëzuan gjithashtu shumë, sepse po i jepnin fund njëherë e përgjithmonë mizorive të popullit shqiptarë në Kosovë nga okupatori serb.

Gjenerali Lama shprehi dëshirën që refugjatët kosovarë të kthehen sa më shpejtë në shtëpitë e tyre, dhe t'i përvishen punës edhe ta ringjallin vendin e tyre. Edhe ai vetë shprehi dëshirën që të shkojë për të ndihmuar këtë popull të vuajtur kaq shumë edhe në rimëkëmbjen e vendit.

Gjenerali Lama na tha se më vonë do të kërkojë dorëheqje nga Shteti shqiptar, që ta e lërë edhe postin e tij të Gjeneralit të Ushtrisë së Shqipërisë të Zonës Kufitare të Kukësit, sepse ishte i dhënë me mish e me shpirtë edhe në çdo mënyrë që të jetë e mundur që ta ndihmojë popullin e tij shumë të dashur, popullin shqiptarë nga Kosova!

Nga fillimi kur u njohëm me Gjeneralin Lama, tek ai pamë se ishte i vendosur dhe i përkushtuar 100% në çfarëdo sfide që t'i vinte, përzgjidhjen e

çështjes me fitoren e luftës. së popullit shqiptarë kundër gjakatarëve serb. Për kohën që kaluam në punë së bashku Maj-qershor 1999, në zyrën e tij në Kukës, lirisht mundë të them se Gjenerali Kudusi Lama ishte një prej patriotëve më të mëdhenjë të kombit shqiptarë që kisha takuar. Në fytyrën e tij shpeshëherë pashë edhe lotët e dhimbjes dhe pikëllimit për luftëtarët e lirisë, për pjesëtarët e UÇK- së kur pësonin ndonjë humbje. Kjo ishte gjëja e cila më lëndonte shpirtin edhe mua personalisht, sepse edhe unë kisha të njejtat dhimbje, por i kujtoj edhe gëzimet që ndanim me të kur ishte kulmi i sukseseve! Për Gjeneralin Kudusi Lama mundë të them lirisht se ai është hero i ditëve tona. Ndjem i privilegjuar që pata rastin të bashkëpunojmë me një personalitet të tillë siç ishte ai. Gjeneral Lama ishte në gjendje që të sakrifikoje gjithëçka, vetëm e vetëm për fitimin e lirisë së popullit të tij shqiptarë. Me të punuam pa ndërprerë, pa kurrëfarë orari, ku për 24 orë gjithmonë ishim të gatshëm për aksion që të përmbylim vuajtjet e mëse 2 milion shqiptarëve që kishin lënë shtëpitë e tyre nga armiku kriminel-gjakatarë serb. Gjeneral Lama kishte përfituar mirënjohjet e konsiderueshme edhe për: trupat e aleancës së NATO-së, e në veçanti për njësitë Ushtarake të Armatës Amerikane, si dhe bashkëpunimin vëllazëror me Lt. Gjeneralin Amerikan John Hendrix, si dhe neve të njësisë tonë të Forcave Speciale të Armatës Amerikane në Kukës, si dhe ndihmën e Forcave Ajrore të NATO-së pa ndihmën e të cilave fitorja do të ishte shumë më e vështirë.

Gjatë përqafimit lamtumirës me Lt. Gjeneralin Hendrix, Gjenerali Lama tha: "Ky është personi që me mish e me shpirtë iu përkushtua detyrës së fitores, dhe me punën e tij të pandalshme e gjuhëzoi dhe e detyroi Presidentin e Jugosllavisë Slobodan Millosheviqin që të gjuhëzohet dhe të nënshkruaj KAPITULIMIN," për çka edhe vetë Gjenerali Hendrix patë shprehë dëshirën që në fund do të donte që edhe ta shqelmonte

liderin fashist serb Millosheviqin. Fjalë të cilën unë ia përkujtova atij sepse na e kishte thënë neve gjatë vizitës së tij në Kukës para disa kohësh. I habitur Gjenerali Hendrix me buzëqeshi dhe më tha: "Po, po por nuk po na lejojnë të tjerët!"

Gjenerali Hendrix gjithashtu ishte shumë i kënaqur edhe për punën që bënë pala e UÇK-së me luftën e tyre, e sidomos me furnizimin e listave të objektivave të caqeve me lëvizjet dhe vendëndodhjen e forcave të armikut serb, ku me të cilat informata na ndihmuan në sulmet e caqeve të bombardimeve që ndërmorrëm. Ai pati fjalë shumë të mira për UÇK-në e cila luftoi në mënyrë profesionale dhe me trimëri dhe me moral jashtëzakonisht të lartë, dhe nuk bënë kurrëfarë flliqësire siç po vepronin luftëtarët e armikut jugosllav.

Kjo bisedë u zhvillua mbi pullazin e objektit ku e kishim adaptuar në vendë pushimi, me tavolinën dhe karrikat e drurit që kishim bërë mbi të, të vendosur mbi stacionin e Policisë Ushtarake të Shqipërisë. Aty në një vend ku i kishim ndërtuar edhe shkallë për t'u ngjitur lartë, dhe atje lartë një tavolinë me karrika për rreth të ndërtuara nga pjesëtarët e grupit tonë, prej nga na bëhej më lehtë dhe vëzhgimi i bombarduesve të avionit të NATO-së.

Për këtë punë të grupit tonë mbetën të habitur që të dy Gjeneralët se si në një mënyrë profesionale dhe kaq të përsosur e kishin rregullu këtë pikë vrojtimi dhe pushimi.

Gjatë kësaj bisede filloi të fryej një erë e fortë nga mali i Gjallicës që ishte përballë neve. Era u rritë aq shumë sa që gjithëçka filloi të luhatej, kurse Gjeneralët ishin të thelluar aq shumë në bisedë sa më duket se as që ndienin për erën e madhe që po fryente. Diku gjatë përkthimit të bisedës nuk mu durua, edhe iu luta nëse pranojnë do të ishte më së miri që të zbrisim poshtë në zyrën tonë që e kishim në përdhese, për çka u pajtuan që të dy me propozimin që iu dhashë dhe menjëherë zbritëm poshtë. Pas zbritjes bisedën e vazhduam edhe për një kohë në zyrën tonë që kishim. Biseda që zhvillohej ishte shumë

e ngrohtë në mes tyre, ishte bisedë vëllazërore në mes dy shokëve të ngushtë me profesion dhe qëllim të njëjtë, dhe që kishin një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë. Nga fundi i bisedimeve Gjenerali Lama shprehi faleminderimet e tij të përzemërta të bashkëpunimit si dhe mu faleminderua edhe mua personalisht për ndihmën me përkthimet dhe këshillat e mia që kisha bërë. Kësaj here Gjenerali Lama gjithëçka e kishte të qartë, dhe se gjithëçka kishte kuptuar mirë gjatë bisedës me Gjeneralin Hendrix. Para se të nisej Gjenerali Hendrix për në shtabin e tij na u lutë që të bëjmë edhe disa fotografi me Gjeneralin Lama si dhe së bashku me grupin tonë bashkëpunues.

Kërkoj të bëjmë foto para një dërrase që kishim bërë në murë, e ku kishim të shenuara shumicën e humbjeve të forcave të armikut pas çdo sulmi nga bombarduesit e NATO's që kishim koordinuar grupi ynë. Në dërrasë shenoheshin numri i të vrarëve serb, numri auto-blindave, tankeve, artilerisë si dhe automjeteve ushtarake të shkatërruara nga bombardimet, për të cilën punë që të dy Gjeneralët haptas na u faleminderuan dhe e vlerësuan punën tonë si dhe thanë se aksionet tona ishin ndër më kryesoret që detyruan dorëzimin dhe kapitullimin e ushtrisë jugosllave.

Na faleminderuan veç e veç secilit dhe të gjithë grupin "Zorro" (shifrën që kishim ne gjatë Operacionit të Forcave Aleate). Siç po shifej ky do të ishte ndoshta edhe takimi i fundit i dy Gjeneralëve që aq ngushtë kishin bashkëpunuar në mes vete gjatë të gjithë këtij operacioni, i cili e kishte detyruar palën e armikut për të përfunduar ëndërrën e tyre shekullore për të mbajtur nën okupim tokat e Dardanisë -të Kosovës, si dhe në nënshkrimin e "Kapitulimit" të shtetit fashist serb...

Me këtë takim të përbashkët gjithëashtu edhe qëndrimin tonë në Kukës i kishte ardhë fundi. Sot u njoftuam se në ditën e nesërme na duhej që të nisemi për në Shtabin e Përgjithshëm të NATO-së në Rinas në afërsi të Tiranës, dhe prej ku do të na caktohej drejtimi dhe lëvizja jonë drejt Kosovës së çliruar. - Kosovës së Pavarur!!!

Prej sot edhe titulli i misionit tonë ndryshon nga forca sulmuese "Operacioni i Forcave Aleate" në atë të misionit paqëruajtës të KFOR-it "Task Forca Skifteri".

Prej sot filloi edhe hyrja e trupave paqëruajtëse nën komandën e NATO-së me emrin KFOR -rit, për në Kosovë, ku menjëherë do të fillojë ngritja e kampit më të ri ushtarak për forcat e ushtrisë Amerikane në Kosovë i quajtur Kampi "Bondsteel" në Sojevë të Ferizajit, dhe më vonë do t'i shtohet edhe një kamp tjetër për forcat Amerikane ai i grupit tjetër që do të quhet Kampi "Monteith" që do të vendoset në kazermën ushtarake të ish armatës jugosllave (JNA) në Gjilan.

Trupat paqëruajtëse të NATO-së

në Kosovë do të ndahen në 5 sektore të ushtarakëve paqëruajtës: Sektori Amerikan (Sojevë dhe Gjilan), Italian (Pejë), Gjerman (Prizren), Francez (Mitrovicë) dhe ai Anglez (Prishtinë).

Informacionet e 24 orëve të fundit

Në Cologne rreth 40 shtete nënshkruan "aktin e stabilitetit" për Ballkanin, si nënshkrues ishin edhe shtetet e G 8, me qëllim që të rindërtojnë dhe rirforcojnë gjendjen ekonomike në Kosovë dhe të gjithë regionin. Ai gjithëashtu ia përkujtoi edhe popullit serb për derisa të përkrahin Presidentin Millosheviq, shteti i tyre nuk do të marrë kurrëfarë ndihme nga perëndimi.

Sekretarja e Shtetit Amerikan Zonja Albright gjatë ditës së sotme arriti në Maqedoni në vizitë të kampit të refugjatëve kosovarë, si dhe aty takoi edhe ushtarët amerikan.

Presidenti Clinton iu gëzua tërheqjes së trupave serbe nga Kosova si dhe ndërprerjes së bombardimeve të NATO-së si "fitimtare", gjithashtu premtoi se së bashku me Bashkësinë Evropjane do të ndihmojnë Kosovën me resurse që kanë nevojë.

Sipas UNHCRsë numri i refugjatëve në regjion është 780,200; në Shqipëri 444,200 Maqedoni 244,500

Mal të Zi 69,800 Bosna 21,700

E diel 13 qershor 1999

Sot ishte një ditë e ngrohtë dhe e bukur, ishte një ditë e fitores por edhe një ditë e mërzitëshme sepse sot po ndaheshim nga Komanda e Armatës së Republikës së Shqipërisë, me të cilën bashkëpunuam për gati dy muaj, dhe ndarja nga qyteti piktoresk i Kukësit si dhe ifaleminderohemi edhe qytetarëve të sajë në mikëpritjen



23 Mars 2001 Gjilan /Kosovë, takimi me Komandant "Remin" Rrustem Mustafa në kazermën e TMK's në Gjilan /Kosovë.

e tyre.

Me t'u zgjuar nga gjumi menjëherë filluam përgaditjet për udhëtim, së pari bëmë mbledhjen dhe paketimin e gjëseneve që kishim, dhe para nisjes tonë për udhëtimin drejt Shtabit Amerikan në Rinas, tani para largimit tonë nga Kukësi po pritnim të takonim edhe shokun, mikun dhe vëllaun tonë më të dashur, njeriun me të cilin bashkëpunuam për gati dy muaj Komandantin e Divizionit të Kukësit Gjeneralin Kudusi Lama! Në orën 11:00 para dite na erdhi Gjenerali Kudusi Lama në takimin e fundit lamtumirës me Njësinë tonë të Forcave Speciale të Armatës Amerikane, i cili erdhi dhe me vete na kishte sjellë edhe nga një shenjë kujtimi të bashkëpunimit tonë që kishim patur deri më sot. Gjenerali Lama me vete kishte sjellë për secilin pjesëtarë të njësisë tonë disa

dhurata të bukura modeste dhe me shumë vlerë. Secilit prej nesh na kishte sjellë nga një Flamur Kombëtarë të Shqipërisë dhe nga një panoramë shumë të bukur me pamjen e veshjeve kombëtare të zonave të ndryshme shqiptare. Ishin shenja me shumë vlerë, dhurata që do t'i ruajmë me nostalgji në shenjë kujtimi për tërë jetën tonë dhe për bashkëpunimin tonë të shkëlqyer dhe mundë të them edhe se bashkëpunimin historik që patëm!

Gjatë këtij takimi lamtumirës iu faleminderuam Gjeneralit Kudusi Lama për bashkëpunimin e ngushtë që patëm, si dhe mikëpritjen dhe kujdesin ai dhe i tërë stafi i tij që treguan ndaj nesh gjatë gjithë kohës derisa ishim aty. Mbetemi me shpresë që të takohemi përsëri, por kësaj here së pari në Kosovën e Lirë, për të cilën ëndërruam edhe

sakrifikuam kaq shumë.

Në ndarje me Gjeneralin Lama edhe njëherë u përqaftuam si vëllau më vëllanë duke i dëshiruar njëri tjetrit shëndet me jetë të gjatë, dhe të gjitha të mirat e kësaj bote!

Gjithashtu i faleminderohemi edhe qytetarëve të Kukësit për ndihmën dhe mikëpritjen që na e bënë kudo që shkuam.

Në orën 12:00 në mesditë, u nisëm drejt Rinasit me dy automjetet tona Hamvee's që kishim në dispozicion që nga fillimi. Kaluam nga Kukësi drejt maleve të larta të Mirditës. Ishte një rrugë e gjatë dhe mjaftë e vështirë, e cila nga lartë na jepte një pamje magjepëse dhe spektakulare me majë të larta të maleve, disa prej të cilave në majet e tyre mbanin dëborë e që dukej sikur t'ia kishin veshur plisin e bardhë shqiptar, si dhe luginave të bukura që shtriheshin para neve në horizont. Gjatë rrugës pamë edhe disa vendbanime të vogla dhe shumë piktoreske!

Ndoshta po përshkonim rrugën e zonjës Eith Durham e cila në përshkrimet e saja na e kishte përshkruar diçka të ngajshme, në kujtimet e saja mjaftë mbresëlënëse për Shqipërinë dhe popullin trim dhe bujarë shqiptarë.

Në Rinas arritëm dikur në mbrëmje, rruga ishte mjaftë e gjatë e që na zgjati rreth 7 orë udhëtimi me automjetet tona ushtarake. Në të arritur në kampin e Armatës Amerikane në Aeroportin e Rinas'it afër Tiranës, nga lodhja e rrugës menjëherë zumë një çadër, i shtruam thasët tonë të gjumit edhe pas një kohe të shkurtër që të gjithë pjesëtarët e njësisë tonë fjetëm, me qëllim që të jemi të gatshëm për udhëtimin e nesërm i cili ishte edhe i gjithë qëllimi i këtij rrugëtimit tim të gjatë prej SHBA-së për në Kosovë. Por kësaj here po shkonim në Kosovën e Lirë, atje ku do të takojmë edhe njerëzit tanë më të dashur!



29 Maj 1999 Kukës/Shqipëri, me Njësinë e Forcave Speciale të Amerikës, në rreshtin e fundit Gjenerali Arbëresho-Amerikan John W. Hendrix dhe Gjenerali Kudusi Lama Komandant në Divizionin e Kukësit

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Vushtrria ndali në barazim Besën

VUSHTRRI, 2 PRILL - Një ndeshje shumë interesante është luajtur të dielën mbrëma në Vushtri, në një ambient të bukur sportiv dhe para një numri të madh shikuesish. U përballën Vushtrria e Besa Famgas, ndërsa pikët u ndanë në fund. Ndeshja e xhiros së 24-t të Superligës A të Kosovës në hendboll përfundoi

31:31. Ekipi pejan ishte në epërsi deri në minutën e 18-të kur rezultati u barazua në 10:10. Më pas vendasit ishin në epërsi prej një goli, kurse deri në fund të pjesës së parë u luajt ndeshje thuajse e barabartë. Në minutën e 44-t, Besa Famgas u shkëput 27:22, por për pesë minuta Vushtrria barazoi në 27:27.

Arbios Mushkolaj shënoi për 31:30 nga shtatmetërshi. Në anën tjetër Halim Miftari u tregua i vëmendshëm dhe shënoi për 31:31 në minutën e 59-të. Në fund të dy skuadrat dështuan në sulm dhe rezultati nuk ndryshoi. Bozhidar Nikoçeviq i shënoi 11 gola për Vushtrrinë, derisa shtatë i kishte

Felippe Teixeira. Te Besa Famgas, nëntë gola i shënoi Arbios Mushkolaj, derisa gjashtë i kishte Jon Muqolli. Besa Famgas udhëheq në tabelë me 42 pikë. Vushtrria ka fituar pikë të rëndësishme në garën për plejof. Është e pesta me 23 pikë, sa i kanë edhe Rahoveci në vendin e tretë dhe Prishtina në të katërtin.



Prishtina përfundon sezonin e rregullt në vendin e parë, Ylli e mbyllë me fitore

PRIZREN, 2 PRILL - Sigal Prishtina ka përfunduar garat e rregullta me fitore dhe si lidere e Prince Caffè Superligës. "Bardhekaltrit" në ndeshjen e fundit kanë mundur Ponte Prizrenin 71:109 (20:39, 23:19, 14:29, 14:22), në javën e 28-të. Sigal Prishtina e nisi takimin më mirë dhe e fitoi çerekun e parë bindshëm 20:39, kurse i dyti ishte më i barabartë, duke përfunduar 23:19, ndërsa skuadrat shkuan në pushim me shifrat 43:58. "Bardhekaltrit" nuk u ndalën në pjesën e dytë, duke ngritur epërsinë dhe triumfuan bindshëm 71:109. Adam Grant ishte më i dalluari te prizrenasit me 21 pikë, kurse te prishtinasit u



dallua Both Gach me 22 pikë, nëntë kërcime e tetë asistime. Ponte Prizreni përfundon në vendin e shtatë me tetë fitore e 20 humbje dhe në "play-out" do të

përballet me Bora-n, ndërsa Sigal Prishtina përfundon garat e rregullta me 22 fitore e gjashtë humbje dhe si lider i Superligës ka siguruar plasmanin në

gjysmëfinale të "play-off"-it. Golden Eagle Ylli ka përfunduar garat e rregullta me fitore, duke mundur Bashkimin me shifrat 77:87 (11:24, 28:16, 24:29, 15:18), në javën e 28-të të Prince Caffè Superligë. Therandasit e nisën ndeshjen furishëm, ku qysh në çerekun e parë krijuan epërsi të lartë prej 17 pikësh, 6:23, ndërsa kjo pjesë përfundoi 11:24. Prizrenasit vazhduan me lojë të mirë dhe dalëngadalë shkryn epërsinë, duke barazuar shifrat në 37:37, e më pas kaluan në epërsi 38:37, kurse pjesa e parë përfundoi 38:40, me një treshe nga Valon Bunjaku. Perioda e tretë nisi e barabartë, por në fund

të kësaj pjese kampionët shkëputën në 57:67, derisa shifrat pas 30 minutash ishin 62:67. Në dhjetë minutat e fundit, Ylli ruajti epërsinë dhe triumfoi 77:87. Te Bashkimi më i miri ishte Daniel Lekndreaj me 31 pikë e 14 kërcime, ndërsa te Ylli më i miri ishte Demetris Morant me dhjetë pikë e 20 kërcime. Bashkimi përfundoi garat e rregullta në pozitën e pestë me 11 fitore e 17 humbje dhe në çerekfinale të "play-off"-it do të ndeshet me Trepçën, kurse Golden Eagle Ylli në pozitën e tretë me 20 fitore e tetë humbje dhe në çerekfinale do të ndeshet me Vëllaznimin.

Drita e Dukagjini me fitore të rëndësishme para tifozëve të vet

PRISHTINE, 2 PRILL - Skuadra e Dritës ka arritur fitore me rezultat bindës kundër Drenicës (3-0) në kuadër të xhiros së 27-të në Albi Mall Superligë. Me këtë fitore, Drita është kthyer në vendin e parë në renditje me 55 pikë, një më shumë se kampioni aktual, Ballkani. Ndërkohë, Drenica mbetet e fundit në tabelë me 23 pikë dhe me shpresë gjithnjë e më të vogla për t'iu shmangur rënies nga elita. Drita vuajti për ta thyer rezistencën e Drenicës, ndonëse kuqezinjët mbeten me një lojtar më pak në fushë në minutën e 36-të pas përjashtimit të Agim Zekës. Shifrat i zhbllokoi Leonat Vitija në minutën e 58-të, derisa më pas realizuan edhe Blend Baftiu (76') dhe Muharrem Jashari (79'). Dukagjini është rikthyer te fitorja pasi në stadiumin "18 Qershori" në Klinë, e ka mundur Ferizajn, me rezultat 3-1. Behar Bardhi kaloi

në epërsi Ferizajn në minutën e shtatë, por Dukagjini u rikthye shpejtë, duke barazuar shifrat pas tre minutash me golin e Victor Hugos. Ndërkaq, në pjesën e dytë, Dukagjini e kapitalizoi mbizotërimin e plotë me dy gola, të cilat i shënuan Marlei Santos (59') dhe Oto John (76'). Dukagjini kthehet në pozitën e gjashtë në renditjen e Superligës me 35 pikë dhe tani mbetet vetëm pesë pikë larg vendit të tretë, që dërgon në Ligën e Konferencës. Ndërkohë, Ferizaj vazhdon të qëndrojë në pozitën e parafundit me 28 pikë. Kampioni në fuqi, Ballkani ka shënuar fitore në derbin e javës së 27-të në Albi Mall Superligë, duke u rikthyer njëherësh së paku për 24 orë në pozitën e liderit. Portokallezjinjtë aritën t'igëzohen tri pikëve para tifozëve të vet në Suharekë në duel me Gjllanin, me rezultat 2-0, duke i dhënë fund serisë



negative prej katër barazimesh e një humbje. Rezultatit e zhbllokoi Meriton Korenica, me golin e shënuar nga distanca në minutën e 20-të, derisa fitoren e vulosi golashënuesi më i mirë i këtij edicioni në elitë, Albion Rrahmani, në minutën e 61-të. Prishtina është rikthyer në stadiumin "Fadil Vokrri" me fitore. Skuadra e drejtuar nga Debatik Curri ka realizuar fitoren e tretë radhazi, kësaj radhe duke e mundur Trepçën '89, me rezultat bindës 4:1. Të parët shënuan

mitrovicasit, me golin e Ardian Mujës, në minutën e 30-të, por në pjesën e dytë bardhekaltrit e kryeqytetit aritën të përmbysin gjithçka. Fillimish shifrat i barazoi Albin Prapashtica (53'), kurse më pas Bujar Pllana me dy gola përmbysi shifrat (56' e 66'), teksa rezultatit përfundimtar, 4-1, e vendosi Shefit Shefiti (85'). Fitore të rëndësishme para tifozëve të vet shënoi edhe Llapi, që në "Zahir Pajaziti" e mundi Malishevën, me rezultat 1-0. Golin e vetëm e shënoi

SUPERLIGA	
Ballkani - Gjllani	2-0
Drita - Drenica	3-0
Llapi - Malisheva	1-0
Prishtina - Trepça '89	4-1
Dukagjini - Ferizaj	3-1
Tabela	
	Pikë
1. Drita	55
2. Ballkani	54
3. Gjllani	40
4. Prishtina	38
5. Llapi	36
6. Dukagjini	35
7. Malisheva	29
8. Trepça '89	29
9. Ferizaj	28
10. Drenica	23

meksikani Francisco Rivera, në minutën e 79-të. Pas kësaj fitoreje, skuadra e Tahir Batatinës stabilizohet në renditje me 36 pikë.

Milani shkëlqen në derbi ndaj Napolit

NAPOLI 2 PRILL - Milani rikthehet në rrugën e fitoreve në Seria A dhe e bën me një sukses spektakolar 4-0 në stadiumin "Maradona" ndaj

Napolit. Rafael Leao zhbllokoi ndeshjen me një gol të bukur me parabolë në minutën e 17-të. 8 minuta më pas Brahim Diaz do të

dyfishonte shifrat, duke i dhënë një goditje të rëndë vendasve. Në pjesën e dytë kur pritej një reagim nga Napoli, Milani do të

realizonte dy gola të tjerë me Leao dhe Saelemaekers. Kuqezinjët me këtë fitore ngjiten në vendin e tretë me 51 pikë, 1 më shumë se Interi.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

